

*BANKA E SHQIPËRISË*

*RAPORTI  
VJETOR 1998*

*MARS 1999*

|            |                                                           |              |
|------------|-----------------------------------------------------------|--------------|
| <b>1.</b>  | <b>Vështrim i Përgjithshëm mbi Ekonominë</b>              | <b>1-7</b>   |
| 1.1        | <i>Ekonomia Botërore 1998</i>                             | 1-7          |
| 1.2        | <i>Ekonomia Kombëtare</i>                                 | 1-12         |
| 1.3        | <i>Çmimet e Konsumit dhe Inflacioni</i>                   | 1-17         |
| 1.4        | <i>Politika Financiare Buxhetore gjatë vitit 1998</i>     | 1-19         |
| 1.5        | <i>Bilanci i Pagesave</i>                                 | 1-21         |
| 1.6        | <i>Kursi Këmbimit dhe Rezerva Valutore</i>                | 1-26         |
| <b>2.</b>  | <b>Zhvillimet Monetare</b>                                | <b>2-29</b>  |
| 2.1        | <i>Politika Monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë</i> | 2-29         |
| 2.2        | <i>Oferta e Parasë</i>                                    | 2-31         |
| 2.3        | <i>Instrumentet Financiare</i>                            | 2-34         |
| <b>3.</b>  | <b>Sistemi Bankar</b>                                     | <b>3-39</b>  |
| 3.1        | <i>Legjislacioni dhe Kuadri Rregullator</i>               | 3-39         |
| 3.2        | <i>Sektori Financiar dhe Ristrukturimi i tij</i>          | 3-41         |
| <b>4.</b>  | <b>Emisioni i Monedhës</b>                                | <b>4-47</b>  |
| <b>5.</b>  | <b>Sistemi i Pagesave në Shqipëri</b>                     | <b>5-48</b>  |
| 5.1        | <i>Informacion i Përgjithshëm</i>                         | 5-48         |
| <b>6.</b>  | <b>Bilanci Kontabël dhe Rezultati Financiar</b>           | <b>6-50</b>  |
| 6.1        | <i>Parimet e Kontabilitetit dhe Metodat e Vlerësimit</i>  | 6-52         |
| 6.2        | <i>Shënime për Bilancin Kontabël</i>                      | 6-55         |
| <b>7.</b>  | <b>Deklarata e Kontrollorit</b>                           | <b>7-62</b>  |
| <b>8.</b>  | <b>Bashkëpunimi Ndërkombëtar</b>                          | <b>8-63</b>  |
| <b>9.</b>  | <b>Në Vend të Mbylljes</b>                                | <b>9-64</b>  |
| <b>10.</b> | <b>Shtojcë Statistikore</b>                               | <b>10-65</b> |

***Fjala e Guvernatorit.***

Raporti i Bankës së Shqipërisë që ju po merrni në duar, përfaqëson një përpjekje të rëndësishme në vlerësimin e zhvillimit të ekonomisë së vendit, veçanërisht të sistemit bankar, gjatë vitit 1998.

Pas prishjes së ekuilibreve makroekonomike një vit më parë, politikat ekonomike të zbatuara nga autoritetet shqiptare, në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare, kanë synuar në rivendosjen e ekuilibreve të tillë që të garantojnë krijimin e një ambienti të përshtatshëm për një rritje ekonomike të qëndrueshme.

Elementi thelbësor i programit të stabilizimit ishte ruajtja e stabilitetit të nivelit të çmimeve. Në përputhje me programin ekonomik, dhe duke përmbyshur kështu edhe objektivin e saj themelor të përcaktuar në ligj, Banka e Shqipërisë ka bazuar edhe vendimet e saj në zbatimin e politikës monetare. Bashkërendimi dhe harmonizimi i drejtë i këtyre politikave monetare me ato financiare të Qeverisë, bënë që niveli i çmimeve në fund të vitit të shënonte një rritje vjetore prej 8.7 për qind, ose 1.3 për qind nën nivelin e programuar.

Vendosja e stabilitetit të çmimeve në qendër të programit ekonomik, shpreh rëndësinë e treguesit të inflacionit në krijimin e kushteve të nevojshme për promovimin ekonomik. Ai krijon premisa që konsumatorët dhe firmat të bazojnë vendimet e tyre ekonomike në informacione të besueshme. Kjo çon në tërësi, në një shpërndarje më eficiente të burimeve ekonomike, e cila, në afat të gjatë, është me rëndësi thelbësore për mirëqënien e shoqërisë.

Në arritjen e stabilizimit makroekonomik, ka qenë i pranishëm me kontributin e tij edhe publiku shqiptar, që me besimin në politikat ekonomike, ndihmoi në ruajtjen e stabilitetit të monedhës sonë kombëtare, pas një rënijeje prej gati 40 për qind të vlerës së saj gjatë vitit 1997. Kjo bëri që Banka e Shqipërisë të ndërhynte shumë pak në treg, kryesisht për të lehtësuar tregun nga qëllimet spekulative.

Rritja e besimit të publikut dhe investitorëve, e shoqëruar me lehtësimin e disahershëm gjatë vitit të kushteve monetare, ndihmoi në zgjerimin e kërkesës së brendshme. Kjo bëri që prodhimi i brendshëm të rikuperohej në nivelet e tij të parakrizës.

Është e natyrshme që politikat stabilizuese, të cilat nga vetë natyra e tyre parashikojnë vendosjen e kufizimeve të forta monetare dhe financiare në ekonomi, kanë edhe koston e tyre sociale. Fundi i vitit rezultoi me rritjen më tej të shkallës së papunësisë dhe shtrirjen e varfërisë në segmente të gjera të popullsisë. Këto probleme të cilat qëndrojnë lart në axhendën e autoriteteve vendimmarrëse, do të përbëjnë dhe sfidën më të rëndësishme të mijëvjeçarit të ri. Banka e Shqipërisë, brenda objektivit të saj të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, do të rishikojë në mënyrë periodike lehtësimin e politikave monetare, të tilla që të krijojnë më shumë hapësira për zgjerimin e sipërmarrjes ekonomike.

Nga ana tjetër, zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale, i janë imponuar deri diku vendimeve të marra. Kështu, gjendja në rajonin e Ballkanit, ku problemi i Kosovës është pa dyshim më i mprehti; thellimi dhe përhapja e krizës ekonomike në mjaft nga vendet e zhvilluara dhe në zhvillim; realizimi i politikës monetare unike në vendet që tashmë krijuan Eurozonën, të finalizuara me hyrjen e euro, u reflektuan në procesin vendimmarrës nga Banka e Shqipërisë. Tendencat gjithëbotërore liberalizuese dhe globalizuese, do të kërkojnë më shumë fleksibilitet dhe maturi të politikave ekonomike që vendi ynë do të zbatojë në të ardhmen.

Më së fundi, Banka e Shqipërisë është e vendosur të vazhdojë dhe të thellojë komunikimin e saj me publikun për të rritur transparencën e vendimeve të marra prej saj, duke e konsideruar këtë komunikim si një mjet themelor që do të garantojë konsensusin e publikut mbi domosdoshmërinë dhe drejtimin e reformave ekonomike.

GUVERNATORI

SHKELQIM CANI

## 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI EKONOMINË

### 1.1 EKONOMIA BOTËRORE 1998.

Në skenën e ekonomisë botërore, viti 1998 shënoi zhvillime mjaft interesante, të dominuara nga dy ngjarje të rëndësishme: realizimi i fazës së tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar të 11 vendeve anëtare të Bashkimit European dhe vazhdimi i krizës aziatike dhe përhapja e saj në Rusi si dhe në mjaft nga vendet në zhvillim.

Që nga 3 maji 1998, Bashkimi European vendosi t'i besojë realizimin e politikës monetare Sistemit të Bankave Qendrore Europiane, të përbërë nga Banka Qendrore Europiane dhe bankat qendrore kombëtare të 11 vendeve pjesëmarrëse.

Nga 1 janari 1999, monedha unike europiane, euro, hyri në veprim, me kurset e këmbimit të fiksuara në mënyrë të pakthyeshme të shpallura në 31 dhjetor 1998. Tashmë këto ekonomi bashkohen nga një monedhë e vetme, dhe nga një politikë monetare unike.

#### Box 1: Monedhat pjesëmarrëse në euro dhe kurset e këmbimit:

|                  | 01/01/199  |                 | 01/01/1999 |
|------------------|------------|-----------------|------------|
| Gjermani (DEM)   | 1.95583    | Irlandë (IEP)   | 0.78756    |
| Francë (FRF)     | 6.55957    | Spanjë (ESP)    | 166.38600  |
| Itali (ITL)      | 1936.27000 | Portugali (PTE) | 200.48200  |
| Hollandë (NLG)   | 2.20371    | Austri (ATS)    | 13.76030   |
| Belgikë (BEF)    | 40.33990   | Finlandë (FIM)  | 5.94573    |
| Luksemburg (LUF) | 40.33990   |                 |            |

Burimi: ECB Monthly Buletin, January 1999.

Hyrja e euro-s përkoi me thellimin e krizës në Japoni e Azi dhe shtrirjen e saj në mjaft nga vendet me ekonomi në zhvillim dhe atyre në tranzicion, më e dukshme kjo në Rusi dhe në vendet e Amerikës Latine.

Këto zhvillime bënë që institucionet ndërkombëtare të rishikonin disa herë parashikimet e bëra për ritmet e rritjes së ekonomisë.

Rritja e prodhimit botëror gjatë vitit 1998<sup>1</sup> llogaritet të arrijë në nivelin prej 2.4 për qind, nga 4.1 për qind që u arrit gjatë vitit të mëparshëm. Faktori kryesor i kësaj rënieje të ritmeve të rritjes mbetet dobësimi i kërkesës së ekonomisë japoneze<sup>2</sup> dhe tregut aziatik në tërësi, që çoi në një përkeqësim të çmimeve të mallrave energjitike dhe joenergjitike në tregjet botërore.

**Tabela 1. Rritja në përqindje kundrejt vitit paraardhës.**

|                                 | 1997 | 1998 |
|---------------------------------|------|------|
| Prodhimi i Përgjithshëm Botëror | 4.1  | 2.4  |
| Vendet e Industrializuara       | 2.9  | 2.4  |
| Bashkimi European               | 2.7  | 2.9  |
| Zona e Euro                     | 2.5  | 3.0  |
| Vendet në Zhvillim              | 5.8  | 2.7  |
| Vendet në Tranzicion            | 2.0  | 1.8  |
| Europa Qendrore dhe Lindore     | 2.8  | 3.5  |
| Volumi i Tregtisë Botërore      | 9.8  | 4.6  |

*Burimi: IMF/World Economic Outlook, 1998.*

Në këtë kuadër, prodhimi i përgjithshëm i ekonomisë amerikane, kryesisht si rrjedhojë e forcimit të kërkesës së brendshme, u rrit me 3.5 për qind, duke shënuar një rënie të lehtë të ritmeve të rritjes krahasuar me vitin e kaluar.

Fuqizimi i dollarit dhe rënia e çmimeve të produkteve energjitike dhe mallrave të tjera, kontribuan në një ulje permanente të inflacionit, i cili rezultoi në fund të vitit në 1.6 për qind. Nga ana tjetër, politikat monetare të adaptuara ndihmuan në mbështetjen e rritjes ekonomike dhe uljen e nivelit të papunësisë, i cili arriti në fund të vitit në nivelet më të ulëta historike prej disa vjetësh.

Megjithë adaptimin e politikave stimuluese ekonomike e fiskale, PPB-ja e Japonisë shënoi një rënie prej 1.7 për qind. Shpenzimet e brendshme ranë në mënyrë të ndjeshme, kryesisht për shkak të dobësive të vazhdueshme në sistemin financiar si dhe të rënies së besimit të investitorëve dhe konsumatorëve.

Një rënie më e ndjeshme goditi ekonominë e vendeve të ASEAN-4, PPB-ja e së cilës ra me 8.8 për qind kundrejt një rritjeje prej 2.3 për qind që shënoi rritja ekonomike e gjithë rajonit të Azisë.

Pavarësisht nga efektet frenuese të diktuar nga kriza aziatike, forcimi i kërkesës së brendshme shërbeu si motori kryesor i rritjes prej 2.9 për qind që shënoi ekonomia e vendeve të Bashkimit European dhe 3 për qind zona e euro-s. Me përjashtim të Britanisë së Madhe dhe të disa prej vendeve Skandinave, vendet e tjera anëtare regjistruan një gjallërim të aktivitetit

<sup>1</sup>Raportimi i të dhënave i referohet Raportit të FMN "World Economic Outlook – Prospects and Policy Issues", gusht 1998; vlerësimeve të bëra nga Banka Qendrore Europiane në buletinet e saj mujore; si dhe dokumenteve të tjera të bankave qendrore.

<sup>2</sup>Japonia zë vendin e dytë me ekonominë më të madhe të vendeve të industrializuara.

ekonomik, veçanërisht ky më i dukshëm në Francë dhe Gjermani, me 3 për qind dhe 2.7 për qind, respektivisht.

Megjithë pozicionet e ndryshme në ciklin e biznesit, treguesit kryesorë në vendet e euro-s vazhduan të konvergojnë drejt niveleve tashmë të përcaktuara në Traktatin e Maastricht-it. Me një nivel mesatar vjetor të inflacionit prej 0.9 për qind të regjistruar në fund të muajit nëntor 1998 dhe një rritje të moderuar të parashikuar për vitin e ardhshëm, duket se stabiliteti i arritur i çmimeve nuk do të kërcënohet. Po kështu, nivelet e interesave afatgjata dhe afatshkurtra, vazhduan të konvergojnë më tej drejt niveleve më të ulëta të Gjermanisë dhe të Francës.

Edhe pse tashmë janë harmonizuar politikat fiskale të vendeve anëtare, raporti mesatar i defiçitit ndaj PPB-së të zonës së euro, sipas Komisionit European, vlerësohet të jetë ulur në 2.3 për qind në vitin 1998 nga 2.5 për qind në vitin e mëparshëm. Ndërsa, raporti i borxhit të përgjithshëm të qeverisë ndaj PPB-së qëndroi në 73.8 për qind, që është përsëri mjaft larg vlerës së referencës prej 60 për qind e përcaktuar në Protokollin nr.5 të Traktatit.

Nivelet e larta të papunësisë, prej 10.8 për qind të regjistruara në fund të vjeshtës 1998 në zonën e euro-s, përbënë sfidën më të rëndësishme për autoritetet vendimmarrëse.

*Vendet në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion të Europës Qendrore dhe Lindore.*

Kriza financiare aziatike këtë rradhë do të përhapej dhe prekte mjaft nga ekonomitë e vendeve në zhvillim, me efekte të konsiderueshme në qarkullimin e kapitaleve private, dobësimin e eksporteve, përkeqësimin e pozitave konkurruese dhe të çmimeve të mallrave. Zbatimi i politikave shtrënguese monetare në mjaft vende, u bë një domosdoshmëri për të siguruar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

Përmirësimet e ndjeshme të politikave ekonomike dhe iniciativat e rëndësishme në lehtësimin e barrës së borxheve të vendeve më të varfra, i siguruan *rajonit të Afrikës* një rritje prej 4.1 për qind, rritja më e lartë e mesatares së 20 viteve të fundit. Autoritetet e Afrikës së Jugut, për shkak të ndikimeve që po merrte ekonomia nga kriza financiare aziatike, ndërhyjnë disa herë në tregjet valutore si dhe rritën përqindjet e interesave gjatë gjysmës së parë të vitit, me qëllim rivendosjen e stabilitetit financiar në vend.

Në *Lindjen e Mesme*, përkeqësimi i pozicioneve fiskale dhe llogarive korente, si pasojë e rënies së ndjeshme të çmimeve të produkteve energjitike, ndikuan ndjeshëm në rënien e ritmeve të rritjes së prodhimit. Ndërkohë, rënia e besimit të investitorëve në tregjet financiare të ekonomive në zhvillim, dobësoi hyrjet e kapitaleve të huaja në *Amerikën Latine*. Kjo i detyroi autoritetet e mjaft prej këtyre vendeve të modifikonin politikat monetare në dëm të rritjes ekonomike. Për rrjedhojë, rritja e prodhimit pritet të arrijë në 3.3 për qind, duke qëndruar kështu gati 2 për qind poshtë nivelit të rritjes së shënuar gjatë vitit të kaluar.

Fuqizimi i programeve të stabilizimit ekonomik dhe vazhdimi i reformave strukturore në vendet në tranzicion të Europës Qendrore dhe Lindore, rezultuan në një progres të dallueshëm në uljen e inflacionit, duke arritur në 18 për qind në fund të vitit 1998. Pas disa vitesh të rënies së prodhimit, rikuperimi i filluar dy vjet më parë vazhdoi edhe gjatë këtij viti në analizë, në nivele lehtësisht më të larta, duke shënuar shifrën prej 3.5 për qind. Arritjet më të rëndësishme u shënuan nga ekonomitë e Polonisë, Republikës Çeke, Hungarisë dhe vendeve Balltike. Ndërkohë, Rusia dhe Ukrahina ishin dy vendet që u ndikuan ndjeshëm nga kriza, duke u përfshirë edhe vetë në të. Kështu, ekonomia ruse ra me 1 për qind ndërsa Ukrahina pritet të arrijë pikën e ndaljes së rënies së prodhimit.

Zhvillime të tilla të ekonomisë botërore, veçanërisht përkeqësimi i kushteve ekonomike në rajonin e Azisë, çuan në një rënie të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.

Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe dobësimi i kërkesës së ekonomisë botërore, rezultuan në një rënie të ndjeshme të volumit të tregtisë botërore të mallrave dhe shërbimeve: nga 9.8 për qind që shënoi rritja në vitin 1997, ky tregues rezultoi vetëm 4.6 për qind gjatë këtij viti.

Ndërkohë që rënia e çmimeve ishte një ndihmë për rritjen ekonomike dhe rënien e mëtejshme të inflacionit në ekonomitë e vendeve të industrializuara, ajo transmetoi efekte negative për ekonomitë e vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion, të cilat janë kryesisht eksportuese të mallrave primare.

Zhvillime të tilla të ekonomisë botërore paraqitën implikime të drejtpërdrejta edhe në ekonominë e vendit tonë. Reflektimet më të rëndësishme janë evidentuar në dinamikën e çmimeve të tregtisë së jashtme të vendit, të cilat transmetuan efektet e krizës së tregjeve të mallrave në një shkallë të konsiderueshme.

Po kështu, bilanci i llogarive kapitale reflektoi shkallën e dobët të rikuperimit të aktivitetit të investimeve të huaja, pjesë kjo edhe e frikës së përgjithshme të komunitetit të biznesit ndaj zhvillimeve në rajonin e Ballkanit si dhe e rënies së interesit të investitorëve për të investuar në vendet me risk të lartë.

Gjithashtu, hyrja e euro pritet që të ketë implikimet e saj jo vetëm në vendet anëtare por, edhe në vendet e tjera. Më të dukshme këto do të jenë në vendet që tashmë kanë themeluar relacione të ngushta ekonomike dhe tregtare me këtë grup vendesh, ku bën pjesë edhe vendi ynë.

**Box. 2: Ndikimet e pritshme të Euro në ekonominë shqiptare.**

Realizimi i Bashkimit Monetar Europian (EMU) nëpërmjet hyrjes së Euro nga 1 janari 1999, shënon evenimentin më të rëndësishëm për sistemin monetar ndërkombëtar që nga shëmbja e sistemit të Bretton Woods. Përveç implikimeve që paraqiten për vetë vendet anëtare të Eurozonës dhe gjithë sistemin monetar ndërkombëtar, implikime paraqiten edhe për ekonominë në tranzicion, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Ndikimet më të rëndësishme të pritshme për ekonominë shqiptare me hyrjen e Euro do të ishin:

*Tregtia e jashtme është kanali më i rëndësishëm potencial i influencimit të EMU në ekonominë e vendit.*

Shqipëria ka intensifikuar ndjeshëm lidhjet e saj tregtare me vendet e BE, duke zënë vendin e parë në gjithë vendet e Europës Qendrore dhe Lindore për shkallën e kësaj lidhjeje, me gati 80 për qind të importeve dhe eksporteve dhe një rritje të ndjeshme të pjesës së saj të tregut në këtë bllok ekonomik.

Për rrjedhojë, këto lidhje tregtare mendohet të jenë edhe kanali kryesor i influencimit. Shkalla dhe masa e këtij ndikimi do të varen nga nivelet e dy treguesve: ndryshimit të rritjes ekonomike (PPB) dhe nivelit të kurseve reale efektive të këmbimit.

*Ndikimi i Euro në Lidhjet Financiare.*

Përveç llogarive korente, repkursione të tjera financiare të Euro mund të përfshijnë ndikime të mundshme të ndryshimeve të normave të interesave dhe kurseve të këmbimit në shërbimin e borxhit të jashtëm dhe në strukturën financiare të vendit.

*Efektet më të pritshme do të përfshinin:*

*Efektet në qarkullimin e kapitaleve si pasojë e ndryshimit të nivelit të interesave të Euro, në krahasim me normat e interesit që zbatohen në vendin tonë.*

*Ndikimi i Euro në rritjen e investimeve dhe diversifikimin e portofoleve.*

*Ndikimi në shërbimin e borxhit.*

Ndikimi i Euro në shërbimin e borxhit të jashtëm shihet në aspektin e ndryshimeve që do mund të ndodhin në normat e interesave brenda vendeve të Eurozonës dhe/ose ndryshimit të kurseve të këmbimit të Euro kundrejt monedhave të tjera ndërkombëtare, sidomos duke patur parasysh nivelin e borxhit tonë të jashtëm.

*Implikimet institucionale të Bashkimit Monetar Europian për vendet joanëtare.*

Për vendet që synojnë anëtarësimin në BE, dhe rrjedhimisht edhe në EMU, paraqiten dy implikime të rëndësishme:

- Këto vende duhet të synojnë plotësimin e kriterëve të konvergimit të përcaktuara në Traktat, përpara se të anëtarësohen. Kjo do të rrisë presionin mbi to në përcaktimin e politikave fiskale, monetare dhe valutore, të tilla që të lehtësojnë konvergimin.
- Pavarësisht nga periudha tranzitore që mund të akordohet, këto vende duhet të plotësojnë, që nga dita e anëtarësimit, të gjitha kërkesat ligjore dhe institucionale. Këto kërkesa, përcaktojnë në veçanti, pavarësi të plotë të Bankës Qendrore, ndalimin e financimit monetar të deficitit të qeverisë dhe liberalizimin e plotë të qarkullimit të kapitaleve, jo vetëm midis vendeve anëtare të BE, por edhe kundrejt vendeve të treta.

Duke konsideruar aspiratat dhe perspektivat integruese të vendit tonë në strukturat europiane, hyrja e Euro paraqet implikime edhe në aspektet e politikave ekonomike, zhvillimeve ligjore dhe institucionale. Një përafrim i mëtejshëm i ligjeve dhe konsolidim institucional (veçanërisht i tregjeve financiare dhe sistemit bankar), janë disa prioritete që duhen adaptuar në axhendën e veprimeve të ardhshme nga autoritetet vendimmarrëse të vendit. Me rëndësi të veçantë paraqitet në këtë drejtim adaptimi i normave dhe qëndrimeve, nga ana e Bankës së Shqipërisë, sipas normave dhe standardeve të Bankës Qendrore Europiane. Me ndryshimet e ndodhura nga hyrja në fuqi e ligjit të ri për Bankën e Shqipërisë në fillim të vitit 1998, *Shqipëria përafrohet me plotësimin e kërkesave institucionale të përcaktuara në Traktatin e Maastricht-it, me përjashtim të kredisë direkte për qeverinë. Megjithatë procesi i realizimeve konkrete është afat gjatë dhe do të kërkojë përpjekje të konsiderueshme nga vendi yne.*

## **1.2 EKONOMIA KOMBËTARE.**

**P**as pothuajse një dekade postkomunizëm, arritjet dhe dështimet në të gjitha drejtimet e menaxhimit të vendit ishin të pranishme. Një vit para mijëvjeçarit të ri, megjithë arritjet gjatë këtij dhjetëvjeçari, Shqipëria vazhdon të përballlet me sfida të mëdha të natyrave nga më të ndryshmet: politike, ekonomike, sociale, si dhe aktuale e të perspektivës.

Ecuria e ndodhive të viteve '90 është e mbushur me episode të pafund ku nuk mungojnë dhe eksperiencia tejet të hidhura si ajo e pranverës së vitit '97, e cila zhvleftësoi disa nga arritjet e viteve të mëparshme të tranzicionit, sidomos ato që kishin të bënin me stabilizimin dhe rregullimet strukturore të ekonomisë.

Edhe zhvillimet ndërkombëtare, në qendër të të cilave ka qenë rajoni ynë, kanë pasur një intensitet të lartë. Konflikti që nisi vitin e kaluar në Kosovë, përbën dhe ngjarjen më të rëndë dhe më të lidhur me ekonominë tonë. Parë në një kuadër më të gjerë, me gjithë përpjekjet e vendeve në tranzicion, sistemi i tyre imunitar vazhdon të mosfunksionojë, e për rrjedhojë krizat financiare herëpashere kanë qenë të pranishme.

Çmimet<sup>3</sup> e importit ranë me rreth 25 për qind, ndërsa ato të eksportit qëndruan gati 40 për qind poshtë niveleve të tyre të vitit të kaluar. Ndikimin më të rëndësishëm në rënien e çmimeve të importit e dhanë grupmallrat e produkteve ushqimore si dhe lëndët e para të importit, si materialet plastike, të industrisë së drurit, të lëkurës dhe materialeve të ndërtimit. Ndërkohë, rënia e çmimeve të eksportit erdhi kryesisht nga rëniet e çmimeve të produkteve minerale, të prodhimeve të industrisë së drurit, artikujve të tekstileve, etj. Përkeqësimi i termave tregtare ka dhënë efektet e tij në thellimin e defiçitit të bilancit të tregtisë së jashtme.

Mbas një periudhe trevjeçare rënieje për vitet 1990-1992 (40 për qind rënie në terma realë), prodhimi i përgjithshëm i brendshëm (PPB) u rrit me shpejtësi, për rreth 9 për qind në terma realë për gjithë periudhën '93-'96. Vlerësohet që kontributi kryesor i rritjes, rreth 60 për qind, ka ardhur nga bujqësia, e cila është privatizuar gjerësisht dhe kishte rritje produktiviteti. Ndonëse në një përqindje më të vogël, një pjesë e rritjes ekonomike i dedikohet ndërtimeve dhe shërbimeve. Norma zyrtare e papunësisë u përgjysmua dhe praktikisht arriti në 12 për qind në vitin 1996. Gjithashtu, rritje pësoi dhe konsumi i PPB-së për frymë. Transferrat private nga emigrantët që u larguan nga Shqipëria në vitet e para të tranzicionit shërbyen si një burim i fuqishëm kursimesh që, nga ana tjetër, ndikuan në rritjen ekonomike.

Ndërsa ekonomia pati përmirësime, procesi i zhvillimit të një shteti me aftësinë e duhur qeverisëse ishte mjaft i vonuar. Kriza e vitit 1997, zbuloi problemet thelbësore në aftësinë e qeverisjes ekonomike të Shqipërisë.

---

<sup>3</sup> Llogaritjet janë bërë në tërësi për gjithë grupmallrat e importit dhe eksportit, pa marrë në konsideratë efektet e ndryshimit të strukturës së mallrave.

Paaftësia, mungesa e dëshirës nga ana e institucioneve përgjegjëse (përfshirë këtu edhe bankat) për të zbatuar ligjet dhe rregullat e saj, lejoi lulëzimin e skemave piramidë në përmasa mjaft të mëdha (detyrimet nominale<sup>4</sup> të këtyre skemave arrinin në 50 për qind të PPB). Kolapsi i paevitueshëm i tyre shkaktoi një krizë të thellë shoqërore. Qeveria humbi kontrollin në zona të mëdha të vendit, shumë prona publike u dëmtuan dhe u shkatërruan dhe mjaft funksione të shtetit u paralizuan. Pasojat e këtij kolapsi u pasqyruan në shthurjen e stabilitetit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Në fund të vitit 1997 PPB-ja ra me 7 për qind, inflacioni arriti mbi 40 për qind dhe norma e këmbimit u zhvleftësua në masën 30 për qind.

Kriza shkatërroi në një masë të gjerë arritjet e Shqipërisë në uljen e nivelit të varfërisë dhe rritjen e të ardhurave. Në vitin 1997 PPB-ja<sup>5</sup> për frymë ishte vetëm 735 dollarë amerikanë. Shqipërisë, që edhe përpara krizës ishte një nga vendet më të varfra të Europës, tanimë i duhet të përshkojë një rrugë të gjatë për të arritur në nivelet e të ardhurave të vendeve fqinjë. Pas krizës, varfëria në Shqipëri u rrit edhe më tej.

Qeveria që doli nga zgjedhjet e qershorit 1997 vendosi një lloj stabiliteti politik dhe social. U kryen reforma të rëndësishme strukturore si dhe në sektorin fiskal. Gjatë gjithë vitit 1998, stabiliteti makroekonomik u përmirësua dukshëm. Inflacioni ishte i moderuar; në bazë vjetore çmimet u rritën vetëm 8.7 për qind. Kursi nominal i këmbimit ishte i qëndrueshëm për gjatë gjithë vitit, ndonëse, në terma realë kursi i këmbimit u rivlerësua gjatë gjithë vitit.

Rezervat valutore, të cilat nuk u përdorën gjatë krizës, kanë qenë vazhdimisht në rritje dhe në fund të vitit 1998 arritën në rreth 4 muaj importe. Ringjallja ekonomike ka filluar dhe kjo dëshmohet nga rritja në shërbime, ndërtim, shërbime bujqësore dhe importe.

Sidoqoftë, paaftësia e vazhdueshme sidomos për të rivendosur rendin është një faktor që kërcënon këtë ringjallje. Ndër dukuritë kryesore që pengojnë dhe kërcënojnë stabilitetin dhe rimëkëmbjen e ekonomisë vendase janë korrupsioni në administratën shtetërore dhe në drejtësi, kontrabanda, mungesa e rendit, tensionet e vazhdueshme politike në vend si edhe konflikti i ashpër në Kosovë. Këto dukuri, ashtu si pothuajse dy vjet më parë, por tani të rishfaqura në përmasa më të vogla, hedhin dritë mbi sfidën kryesore që përballon Shqipëria. Kjo sfidë është ndërtimi i një shteti të besueshëm dhe transparent me aftësi qeverisëse. Shqipëria duhet të bëjë përparime të mëdha në këtë drejtim, në mënyrë që të krijohen kushtet e përshtatshme për vazhdimin e zbatimit të reformës ekonomike dhe që kjo reformë të ketë efekte pozitive afatgjata që janë edhe qëllimi për të cilin ajo është hartuar. Sfidë kryesore këtu qëndron në krijimin e ndjenjës së besimit të shqiptarëve tek shteti.

---

<sup>4</sup> Vlerësim i Bankës Botërore.

<sup>5</sup> Vlerësim i Bankës Botërore.

### 1.2.1 Prodhimi.

Sipas vlerësimeve zyrtare më të fundit, prodhimi i përgjithshëm<sup>6</sup> për vitin 1998 është rritur në masën 8 për qind, gjë që e çon prodhimin në nivelin e parakrizës. Edhe këtë herë prodhimi në sektorin privat (bujqësi, ndërtim dhe shërbime) ka siguruar mbi 70 për qind të tij.

**Tabela 2. Prodhimi i Brendshëm Bruto**

| Në milionë lekë        | 1990   | 1991   | 1995    | 1996    | 1997    | 1998    |
|------------------------|--------|--------|---------|---------|---------|---------|
| PPB me çmime korente   | 16,813 | 16,404 | 229,793 | 280,998 | 341,716 | 456,766 |
| PPB me çmime konstante | 16,813 | 12,105 | 15,107  | 16,478  | 15,325  | 16,857  |
| PPB (ndryshimi në %)   | -10.0  | -28.0  | 13.3    | 9.1     | -7.0    | 8.0     |
| Industria              | -14.2  | -42.0  | 6.0     | 13.6    | -5.6    | ...     |
| Bujqësia               | -5.4   | -17.4  | 13.2    | 3.0     | 1.0     | ...     |
| Ndërtimi               | -12.0  | -30.0  | 21.2    | 18.4    | -6.3    | ...     |
| Transporti             | -10.0  | -30.0  | 18.8    | -1.0    | -20.5   | ...     |
| Të tjera               | -8.0   | -14.0  | 13.5    | 20.1    | -25.0   | ...     |

*Burimi: Ministria e Financave.*

Megjithëse të dhënat zyrtare flasin për një rritje të lehtë, në kufirin rreth 2 për qind, prodhimi industrial duket se edhe për disa kohë do të vazhdojë të vuajë trashëgiminë e varfër që Shqipëria pati në fillim të viteve '90, shkatërrimet e mëdha të kësaj periudhe si dhe ngadalsinë e pajustificueshme në kryerjen e rregullimeve strukturore (sidomos zvarritjet në privatizimin e kapaciteteve potenciale prodhuese). Ky konkluzion përforcohet më shumë kur i referohesh indeksit të volumit të prodhimit industrial në sektorin shtetëror, ku edhe gjatë vitit 1998 vazhdoi kontraktimi në disa sektorë jetikë si ai i kromit, mineraleve etj.

Edhe gjatë vitit 1998, bujqësia dhe industria përpunuese e prodhimeve bujqësore vazhdoi të jetë baza e rritjes ekonomike për shkak të kontributit të saj të madh në PPB.

Niveli i lartë vjetor i rritjes, për shkak të ndryshimit të pronësisë mbi tokën dhe zhvillimi që ka marrë prodhimi blegtoral<sup>7</sup> ka vazhduar dhe gjatë këtij viti. Megjithatë, në bujqësi akoma nuk po vihen re shenja të organizimit, kooperimit, e për rrjedhim ekonomia bujqësore vazhdon të jetë e copëzuar në mijëra pjezësa të vogla, efektiviteti i të cilave nuk zgjat shumë. Problemet me ndarjen e tokës së punueshme, mungesa e kredive dhe e mbështetjes financiare, paaftësia në thithjen e financimeve, etj. në një kohë të shkurtër mund të zbehin ndjeshëm rolin e prodhimit bujqësor në rritjen ekonomike të vendit.

<sup>6</sup>Në terma realë për vitin 1998.

<sup>7</sup>Aktualisht, llogaritet që rreth 70 për qind e totalit të prodhimit bujqësor sigurohet nga blegtoria.

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të pronës dhe të krijimit të kuadrit të përshtatshëm ligjor dhe institucional për zhvillimin e tregut të tokës, Qeveria ka hartuar dhe po zbaton një Plan Veprimi për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme. Finalizimi i reformës së tokës dhe funksionimi i tregut të saj, do të kontribuojnë në rritjen e produktivitetit të sektorit bujqësor.

Kërkesa e brendshme gjatë gjithë vitit ka pësuar rritje. Kjo duke gjykuar sipas disa treguesve si rritja e konsumit të energjisë elektrike, karburanteve dhe të importeve për zëra të tilla si mallrat elektroshtëpiake etj. Në tabelën 3 jepet ndryshimi në përqindje (të dhënat në natyrë) për disa nga këta zëra.

**Tabela 3. Tregues të kërkesës.**

|                                              | Njësia    | Realizimi '98 | Ndryshimi '98/'97 |
|----------------------------------------------|-----------|---------------|-------------------|
| Konsumi i energjisë elektrike                | Mln.Kh    | 713           | 11                |
| Konsumi i karburanteve                       | Mijë tonë | 144           | 108               |
| Totali i importeve të autovehikulave         | Numër     | 4778          | 29                |
| Totali i importeve të TV dhe makinave larëse | Numër     | 23579         | 44                |
| Konsumi i çimentos                           | Mijë tonë | 622           | 43                |

**Burimi: INSTAT.**

Megjithëse ekzistojnë indikatorë të besueshëm të cilët mbështesin një ekspansion të prodhimit të ndërtimit, përsëri duhet theksuar se investimet po përqendrohen kryesisht në ndërtimin e banesave e për rrjedhim nuk po i shërbehet ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese. Ky fenomen, gjykojmë se mund të ketë pasojë në sigurimin e rritjes së qëndrueshme në të ardhmen jo shumë të largët të vendit.

### **1.2.2 Të ardhurat dhe punësimi.**

Niveli i papunësisë gjatë vitit 1998 u rrit më tej. Zhvillimi i ekonomisë, jo në ritmet normale të saj, si dhe mungesa e investimeve të reja prodhuese, ndikuan në moskrijimin e vendeve të reja të punës si dhe mosthithjen e shtesës natyrore të fuqisë punëtore. Edhe projektet publike nuk qenë të afta të ndikonin pozitivisht në këtë drejtim.

Megjithë vlerësimet pozitive për një rritje të prodhimit, përsëri niveli (fondi i nëntëmujorit) për treguesin e papunësisë është mjaft i lartë. Më konkretisht, përqindja e papunësisë<sup>8</sup> arriti në 17.5 për qind të forcës së punës, krahasuar me 14.9 për qind në fund të vitit 1997.

Struktura e punësimit ka mbetur po ajo, ku sipas të dhënave sektori privat rural ka mbi 700 mijë vetë. Edhe dy sektorët e tjerë, krahasuar me vitin e kaluar, kanë pësuar ndryshime të vogla, pothuaj të papërfillshme.

<sup>8</sup> Gjithësesi, të dhënat mbi punësimin, në pjesën më të madhe, bëjnë fjalë për vlerësime, të cilat, për shkak të lëvizjeve të popullsisë brenda vendit dhe jashtë, mbartin pasaktësi. Për rrjedhojë, shifrat mbi këtë tregues duhet të merren me rezerva.

Megjithëse mungojnë të dhënat e besueshme për nivelin e të ardhurave nuk ka dyshim që ato kanë pësuar njëfarë rritje. Dërgesat e mëdha valutore nga emigrantët, rritja konstante e depozitave me afat gjatë gjithë vitit 1998 etj. mbështesin argumentin e mësipërm. Megjithatë, duhet pranuar se megjithë rritjen e pagave nominale të të dy sektorëve, akoma nuk mund të thuhet se ato (pagat) përbëjnë faktorë të qenësishëm në rritjen e të ardhurave të individëve. Edhe për disa kohë, ndoshta për një periudhë afatmesme, emigracioni do të përbëjë burimin bazë të të ardhurave të individëve.

Nga ana tjetër, pagat e ulta dhe struktura e tyre e papërshtatshme ka ndikuar në motivim të dobët, dhe në largime të personelit të kualifikuar nga administrata publike.

### 1.3 ÇMIMET E KONSUMIT DHE INFLACIONI.

**O**bjektiv kryesor i programit afatmesëm të zhvillimit të ekonomisë kombëtare ka qenë dhe është nxitja e zhvillimit ekonomik të vendit dhe përmirësimit të pozicionit të jashtëm në kushtet e një stabiliteti të çmimeve, domethënë i një përqindjeje të ulët dhe të qëndrueshme inflacioni. Stabiliteti i çmimeve megjithëse nuk eliminon ciklet ekonomike, çon në një lëkundje ciklike më të moderuar dhe ndikon në përmirësimin real të standardit të jetesës. Gjithashtu, ai është i nevojshëm për zhvillimin e tregut të kapitaleve ku mund të merret hua në mënyrë më të volitshme e më të lirë për periodha afatgjata.

Në vitin 1998, rritja vjetore e çmimeve të konsumit pësoi një ngadalsim të ndjeshëm duke regjistruar vetëm 8.7 për qind, krahasuar me 42 për qind në dhjetorin e vitit 1997. Ndryshimet strukturore në bashkësinë e faktorëve që ndikojnë ecurinë e çmimeve të konsumit ishin të pranishme, ndonëse efekti i tyre vlerësohet të ketë qenë pozitiv.

**Tabela 4. Indeksi i Çmimeve të Konsumit**

| Dhjetor 1993 = 100%                 | 1993  | 1995  | 1996  | 1997  | 1998  |
|-------------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) | 100.0 | 122.8 | 144.2 | 204.8 | 222.6 |
| Ndryshimi 12-mujor i IÇK-së, në %   | 30.9% | 6.0%  | 17.4% | 42.1% | 8.7   |

*Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.*

Faktorët karakteristikë të një ekonomie në tranzicion (ndryshimet ekstensive në strukturën e ekonomisë, rritja e tatimeve indirekte, rregullimet në çmime) ishin të papërfillshëm ose pothuajse munguan gjatë vitit 1998, ndërkohë që influenca e faktorëve karakteristikë të ekonomive të zhvilluara (kursi nominal i këmbimit, përqindja e interesit, presionet e kërkesës dhe ofertës) jo vetëm ishte e pranishme por, ishte përcaktuesja kryesore në vendosjen e kontrollit mbi rritjen e çmimeve.

Viti që lamë pas, me përjashtim të rritjes së pagës nominale<sup>9</sup> të punonjësve buxhetorë, nuk shënoi ndonjë masë tjetër fiskale që të nxiste shtimin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Për më tepër rishikimi i akcizave në muajin mars '98, bëri që çmimet e një kategorie mallrash të forta të pësojnë rënie. Për shkak të peshës së ulët që këto mallra kanë në shportë, ndikimi i këtij fenomeni në IÇK u zbeh ndjeshëm.

Politika e matur monetare, e harmonizuar me atë financiare-buxhetore, vlerësohet të jetë një nga kontribueset kryesore në vendosjen e kontrollit mbi çmimet. Një nga instrumentet e politikës monetare që çuan në një përqindje inflacioni të moderuar, në fund të vitit 1998, ishte politika elastike me përqindjen e interesit për depozitat dhe stabiliteti i Lekut me tendencë të vazhdueshme forcimi.

<sup>9</sup> Efekti i kësaj rritjeje ishte i fortë në momentin e shpalljes nga Qeveria të këtij vendimi fiskal, tremujori i fundit i vitit 1997.

Edhe gjatë vitit 1998, ecuria e shportës së çmimeve të konsumit, në pjesën dërrmuese të saj, u përcaktua nga çmimet e grupit “ushqim, pije dhe duhan”, fenomen ky që ka zbehur ndjeshëm efektet e ndryshimit të çmimeve të mallrave të tjera të konsumit (si veshmbathjeve, mobilijeve, orendive, shërbimeve etj). Është fakt se rreth 72 për qind e buxhetit familjar shpenzohet për ushqime duke manifestuar nivelin e ulët të të ardhurave për shumicën e familjeve shqiptare. Gjithësesi, vëzhgimi me anë të shportës së kufizuar të mallrave është relativisht i vjetër dhe gjykohet se ka ardhur momenti për përsëritjen e anketës, për të pasqyruar më mirë ndikimet e dy viteve të fundit në sjelljen dhe të ardhurat e konsumatorëve shqiptarë.

Vënia nën kontroll e inflacionit ishte një nga arritjet më të veçanta të vitit të parë të programit afatmesëm të zhvillimit ekonomik të vendit, por vazhdimësia e stabilitetit të çmimeve mbetet një problem që kërkon vëmendje të veçantë të të gjithë komponentëve përbërës të programit. Eksperienca e vitit 1996, tregoi se mbajtja e inflacionit në nivel njëshifror është relativisht e vështirë, kur nuk vazhdohet të ecet me shpejtësi në kryerjen e rregullimeve strukturore të ekonomisë e, për më tepër, kur këto rregullime shoqërohen dhe me devijime të politikave fiskale nga programi. Në këto dy aspekte, Banka e Shqipërisë shikon dhe drejtimet kryesore në të cilat duhet punuar shumë. Ajo do të synojë në ndjekjen e një politike monetare me efekte maksimale dhe në sigurimin e një stabiliteti afatgjatë në rritjen e IÇK-së.

#### **1.4 POLITIKA FINANCIARE BUXHETORE GJATË VITIT 1998.**

**K**onsolidimi fiskal, reduktimi i defiçitit buxhetor, është një nga përbërësit bazë të çdo programi stabilizimi, që ka ndikimin e tij të ndjeshëm në rritjen ekonomike, stabilitetin e çmimeve dhe sidomos në luftën kundër inflacionit në periudhë afatgjatë.

Politika financiare-buxhetore për vitin 1998, që gjeti pasqyrimin e saj edhe në miratimin e ligjit të buxhetit të shtetit, kishte për qëllim reduktimin e defiçitit buxhetor të financuar nga burime të brendshme në 6.6 për qind të PPB-së. Synimet e politikës financiare-buxhetore ishin që gjatë vitit 1998 të kishim një defiçit buxhetor jo vetëm më të ulët se në vitin e mëparshëm, por dhe një politikë shpenzimesh më elastike ku prioritet do të merrnin shpenzimet kapitale. Ky ligj u korrigjua edhe një herë gjatë vitit, në fund të tetorit 1998, duke rritur të ardhurat (si tatimore ashtu dhe ato jotatimore) dhe shpenzimet rreth 700 milionë lekë.

Shkurtime të financimit me burime të brendshme, mendohej se do të zbuteshin nga një mbështetje e fuqishme financiare e jashtme.

Përmirësimi i situatës së buxhetit të shtetit, në kushtet e vitit 1998 ishte një detyrë mjaft e vështirë, po të merren parasysh kushtet e vitit të mëparshëm dhe të viteve paraardhëse dhe rrjedhimet që patën ato në stabilitetin e brishtë ekonomik të vendit. Nga ana tjetër, synimi ambicioz për të ardhurat kërkon një element të rëndësishëm, reformën fiskale.

Gjatë vitit 1998 vazhdoi të thellohet reforma e sistemit fiskal jo vetëm duke zgjeruar disi bazën e tatueshme por, edhe nëpërmjet modernizimit të tij, që ai të bëhej sa më i thjeshtë dhe racional. Në përpjekje për të zvogëluar evazionin fiskal të pranishëm prej shumë kohësh, u bë një rishikim i përqindjeve të akcizave për mallra të ndryshme. Po kështu, një masë tjetër nxitjeje fiskale ishte zvogëlimi i ndjeshëm i taksave doganore për disa nga lëndët e para kryesore bujqësore.

Rregullimet e bëra buxhetit të shtetit, në muajin tetor 1998, parashikonin rritjen: e të ardhurave nga TVSH-ja<sup>10</sup> dhe nga taksat doganore mbi rreth 2 herë krahasuar me vitin 1997, e të ardhurave nga akcizat në masën 3 herë dhe e të ardhurave të tjera tatimore mbi nivelet e rritjes së PPB-së dhe të nivelit të inflacionit.

Në të njëjtën masë do të rriteshin dhe shpenzimet korente së bashku me ato kapitale, ndërkohë që kufiri maksimal i financimit të defiçitit të buxhetit nga burime të brendshme mbeti i pandryshuar në nivelin 6.6 për qind të PPB-së.

Pamja e përgjithshme e treguesve të buxhetit, megjithë vështirësitë, tregon se po shkohet drejt një normaliteti në stabilizimin dhe rritjen ekonomike.

---

<sup>10</sup> Zbatimi në masën 20 për qind i TVSH-së në fund të vitit 1997, (nga 12.5 për qind që ishte më parë) dha ndikimin e vet të plotë gjatë vitit 1998.

Tabela 5. Llogaritë e Buxhetit të Shtetit (në miliardë lekë).

|                               | 1995         | 1996         | 1997         | 1998 Plan   | 1998 Fakt    |
|-------------------------------|--------------|--------------|--------------|-------------|--------------|
| Totali i të ardhurave         | 53.7         | 51.5         | 56.3         | 101.2       | 93.5         |
| Totali i shpenzimeve          | 77.1         | 87.9         | 100.8        | 163.6       | 141.2        |
| <b>Defiçiti Buxhetor</b>      | <b>23.4</b>  | <b>36.4</b>  | <b>44.5</b>  | <b>63.8</b> | <b>47.7</b>  |
| Financimi i jashtëm           | 8.5          | 7.7          | 6.4          | 33.4        | 20.1         |
| Financimi i brendshëm*        | 14.9         | 28.7         | 38.1         | 30.4        | 27.6         |
| <b>Përqindje ndaj PPB-së</b>  |              |              |              |             |              |
| Defiçiti buxhetor             | 23.4         | 18.3         | 16.5         |             | 10.4         |
| Financimi i jashtëm           | 13.3         | 12.4         | 11.3         |             | 4.4          |
| Financimi i brendshëm*        | -1.9         | -6.6         | -8.6         |             | 6.0          |
| <b>PPB (me çmime korente)</b> | <b>229.8</b> | <b>281.0</b> | <b>341.7</b> |             | <b>456.8</b> |

Burimi: Ministria e Financave.

\*Në financimin e brendshëm janë përfshirë dhe të ardhurat nga privatizimi.

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, deficieti buxhetor në fund të vitit rezultoi 47.7 miliardë lekë (13.9 për qind e PPB-së) ose rreth 75 për qind e atij të programuar. Gjithësesi, me interes është fakti se pjesa e deficitit e mbuluar me burime të brendshme është vetëm 27.6 miliardë lekë ose rreth 91 për qind e planit të miratuar.

Krahasuar me dy vitet e mëparshme kjo pjesë e deficitit, si përqindje e PPB-së, ka ardhur vazhdimisht në rënie. Më e dukshme është në raport me vitin 1997, rreth 2.6 pikë përqindjeje. Në mungesë të të dhënave përfundimtare është e vështirë të jepet një pasqyrë e saktë për zhvillimet në grupet e veçanta të të ardhurave dhe të shpenzimeve. Megjithatë, niveli i realizimit të tyre si total për të ardhurat dhe shpenzimet rezulton të jetë respektivisht në masën 93.8 për qind dhe 86.3 për qind e planit.

Shprehur në raport me prodhimin e përgjithshëm, totali i të ardhurave regjistron 20.5 për qind të PPB-së, rreth 4 pikë përqindjeje më shumë se viti 1997. Nga ana tjetër, totali i shpenzimeve regjistron rreth 31 për qind të PPB-së, diçka më shumë se 1 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë.

## **1.5 BILANCI I PAGESAVE.**

**E**kspansioni i shkëmbimeve në aktivitetet tregtare e financiare, reduktimi i deficitit korent, rritja e njëkohëshme e detyrimeve dhe mjeteve financiare ndaj botës e shoqëruar me rritjen e rezervave të Autoritetit Monetar, përbëjnë në vija të përgjithshme zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për vitin 1998. Statistikat e bilancit të pagesave dëshmojnë rigjallërimin e aktivitetit ekonomik me botën. Megjithatë, ekonomia vuan ende pasojat e krizës së vitit 1997 dhe reflekton situatën e rënduar të rajonit dhe kapriçiot politike në vend. Tregues të rëndësishëm si eksporti dhe investimet e huaja janë ende larg niveleve të vitit 1996.

Vëllimi i tregtisë së jashtme (eksport-import) është rigjallëruar gjatë vitit 1998. Si xhiro tregtare ajo është rritur në total 20 për qind kundrejt vitit 1997, me karakteristikë dalluese rritjen e ritmit të eksportit në masën 31 për qind, në një kohë që importi është rritur vetëm 17 për qind kundrejt vitit të mëparshëm. Megjithatë, deficitin e bilancit tregtar për vitin 1998 vlerësohet se arrin shumën 603 milionë dollarë që përfaqëson 19 për qind të PPB-së. Kryesisht janë importet e larta si vëllim ato që kanë shkaktuar këtë deficit. Fatkeqësisht, grupmallrat kryesorë të importit edhe këtë vit kanë qenë ato të konsumit dhe veçanërisht mallra ushqimore dhe mallra konsumi të përdorimit afatgjatë, që zënë 35 për qind të totalit të importeve. Ndërkaq, importet e makinerive dhe pajisjeve vlerësohen në masën 80 për qind të sasisë së vitit të kaluar dhe pesha e tyre specifike në totalin e importeve ka rënë me 6 për qind. Një faktor që ka ndikuar në këtë gjendje është shfuqizimi i dispozitave ligjore (në fund të vitit 1997) që përjashtonin nga tagrat doganore importimin e makinerive dhe pajisjeve për investime në firmat e prekura nga trazirat e vitit 1997.

Vlerësohet që në fund të vitit 1998 llogaria korente regjistroi një deficit prej 65 milionë dollarë amerikanë<sup>11</sup>. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat korente gjatë vitit 1998 janë rritur 60 për qind kundrejt një rritjeje vetëm 19 për qind në shpenzimet korente. Statistikat e bilancit të pagesave paraqesin zhvillime të ndryshme në të dy gjashtëmujorët e vitit. Gjashtëmujori i parë është karakterizuar nga një deficit i lartë korent i cili është përballuar nga kursimet e pjesës tjetër të botës. Në gjysmën e dytë të vitit suficitet korent e kanë vendosur Shqipërinë në një pozicion neto importues mjetesh valutore (ka një rritje të mjeteve valutore neto të rezidentëve), megjithëse ka vazhduar rritja e mëtejshme e detyrimeve dhe rezervave valutore. Deficiti i llogarisë korente, përjashtuar transfertat shtetërore, vlerësohet vetëm 52.6 për qind e atij të vitit 1997, dhe përfaqëson 4.9 për qind të PPB-së kundrejt 12 për qind në vitin 1997. Dërgesat nga emigrantët, jashtëzakonisht të mëdha, mbeten shkaku kryesor pas mbulimit të deficitit tregtar në rritje të mallrave dhe shërbimeve.

<sup>11</sup> Që këtu e më poshtë termi dollar nënkupton njësinë amerikane të monedhës.

Tabela 6. Bilanci i pagesave (në milionë USD; shenja minus tregon debinë).

|                                          | 1992         | 1993         | 1994         | 1995         | 1996         | 1997          | 1998         |
|------------------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|--------------|
| <b>Llogaria korente</b>                  | <b>-50.8</b> | <b>14.7</b>  | <b>31.2</b>  | <b>36.6</b>  | <b>-62.4</b> | <b>-256.1</b> | <b>-65.0</b> |
| Eksporti i mallrave, fob                 | 70.0         | 111.7        | 141.3        | 204.8        | 243.7        | 158.6         | 208.0        |
| Importi i mallrave, fob                  | -540.5       | -601.6       | -601.0       | -679.8       | -922.0       | -693.5        | -811.7       |
| Bilanci tregtar                          | -470.5       | -489.9       | -459.7       | -475.0       | -678.3       | 534.9         | -603.6       |
| Shërbimet: kredi                         | 20.3         | 77.5         | 83.1         | 98.2         | 127.3        | 66.3          | 86.6         |
| Shërbimet: debi                          | -89.2        | -162.0       | -97.6        | -106.4       | -142.3       | -101.9        | 129.3        |
| Të ardhurat: kredi                       | 2.6          | 64.9         | 55.6         | 70.8         | 83.5         | 61.6          | 86.1         |
| Të ardhurat: debi                        | -37.7        | -31.0        | -41.5        | -28.5        | -12.0        | -11.9         | -8.7         |
| Transferta private                       | 150.0        | 274.8        | 374.1        | 348.9        | 476.0        | 235.7         | 421.3        |
| Transferta shtetërore                    | 373.7        | 280.4        | 117.2        | 128.5        | 83.4         | 29.0          | 82.6         |
| <b>Investime direkte</b>                 | <b>20.0</b>  | <b>58.0</b>  | <b>52.9</b>  | <b>70.0</b>  | <b>90.1</b>  | <b>47.5</b>   | <b>45.0</b>  |
| <b>Investime portofoli</b>               | <b>0.0</b>   | <b>0.0</b>   | <b>0.0</b>   | <b>0.0</b>   | <b>0.0</b>   | <b>0.0</b>    | <b>0.0</b>   |
| <b>Kapitale të tjera</b>                 | <b>10.7</b>  | <b>52.1</b>  | <b>16.5</b>  | <b>-93.1</b> | <b>-37.9</b> | <b>97.1</b>   | <b>2.0</b>   |
| Sektori rezident shtetëror               | 55.0         | 106.9        | 119.0        | -24.6        | 67.4         | 49.2          | 124.0        |
| Bankat tregtare                          | -59.6        | -43.5        | -80.2        | -56.9        | -112.5       | 81.4          | -92.3        |
| Sektorët e tjerë                         | 15.3         | -11.4        | -22.3        | -11.6        | 7.2          | -33.6         | -29.8        |
| <b>Gabime dhe harresa neto</b>           | <b>44.8</b>  | <b>-9.9</b>  | <b>-45.8</b> | <b>57.1</b>  | <b>57.2</b>  | <b>143.1</b>  | <b>73.4</b>  |
| <b>Bilanci i përgjithshëm</b>            | <b>24.7</b>  | <b>114.9</b> | <b>54.8</b>  | <b>30.6</b>  | <b>47.0</b>  | <b>43.8</b>   | <b>63.3</b>  |
| <b>Rezervat</b>                          |              |              |              |              |              |               |              |
| Rezervat                                 | -24.7        | -114.9       | -54.8        | -30.6        | -47.0        | -43.8         | -63.3        |
| Përdorim kredish dhe huash nga FMN       | 13.9         | 16.6         | 22.2         | 11.1         | 0.0          | 12.2          | 7.9          |
| Detyrime ndaj autoritet. të huaja monet. | ...          | ...          | ...          | ...          | ...          | ...           | ...          |
| Financime të jashtëzakonshme             | ...          | ...          | ...          | ...          | ...          | ...           | ...          |
| <b>Për t'u pasur në vëmendje</b>         |              |              |              |              |              |               |              |
| Ndryshimi total në rezerva               | -24.9        | -114.9       | -54.8        | -30.6        | -39.5        | -28.3         | -75.9        |
| nga të cilat: Rivlerësim                 | ...          | -3.8         | 7.3          | 5.1          | -7.3         | -15.5         | 12.6         |

**Burimi: Banka e Shqipërisë.**

Rritja e vëllimit të përgjithshëm të eksporteve i dedikohet veçanërisht rritjes së vlerës së rieksperteve nga përpunimi. Produktet e industrisë tekstile dhe prodhimit të këpucëve në formën e rieksperteve nga përpunimi aktiv përbëjnë rreth 60 për qind të totalit të eksporteve për vitin 1998. Peshë të rëndësishme në strukturën e eksportit zënë edhe eksportet e mallrave ushqimore dhe produktet minerale. Brenda kësaj kategorie, rritjen më të madhe e kanë regjistruar eksportet e produkteve minerale me mbi 2.5 herë.

Ndryshimet në strukturën e grupmallrave nuk u shoqëruan me ndryshime në peshën e partnerëve kryesorë tregtarë. Tregtia e jashtme mbetet e orientuar drejt vendeve të Europës Perëndimore. Italia, Greqia dhe Gjermania zënë 80 për qind të totalit të transaksioneve tregtare me botën. Rreth 86 për qind e eksporteve kishin si destinacion këto vende, ndërkohë që prej tyre është importuar mbi 76 për qind e mallrave. Italia vazhdon të mbetet partneri më i madh i Shqipërisë në tregti. Greqia është partneri i dytë pas Italisë, pjesa e saj me tregun e importeve është rritur me 2.5 pikë përqindjeje, e barabartë me rënien e importeve nga Italia dhe Gjermania.

Edhe shërbimet në vija të përgjithshme vazhduan të ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Në fund të vitit ato regjistruan një deficit prej 40 milionë dollarë ose 20 për qind më të lartë se një vit më parë. Kjo, pasi zhvillimet në llogarinë e shërbimeve diktohen nga ecuria e shërbimeve të transportit të mallrave dhe shërbimeve të sigurimit, deficitin e të cilave shkon në korelacion të plotë me deficitin tregtar. Në dallim nga viti i kaluar, deficitin

të këtyre shërbimeve i është shtuar edhe defikiti i “shërbimeve të tjera” dhe kjo është pasojë e rënies së të ardhurave nga shërbimet qeveritare. Defikitet e përmendura më sipër u zbutën nga bilanci pozitiv i veprimtarisë së turizmit. Të ardhurat nga ky aktivitet gjatë vitit 1998, janë rritur më shumë se dy herë kundrejt vitit 1997.

Shpërthimi i konfliktit dhe operacioneve ushtarake kundër popullsisë civile në Kosovë solli si pasojë zhvendosjen e grupeve masive të shqiptarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Zhvendosja masive e shqiptarëve ka tërhequr vëmendjen e organizatave humanitare ndërkombëtare, që kanë sjellë në Shqipëri sasi të mëdha ndihmash humanitare në mallra të cilat kanë hyrë në ekonomi si transferta korente.

Ashtu si edhe çdo vit ekonomia shqiptare përfiton burime valutore nga puna e emigrantëve sezonalë apo punëtorëve të zonave kufitare, dhe nga investimet e mjeteve valutore në formën e depozitave me institucionet financiare jorezidente. Ndërkohë, ekonomia vazhdon të shlyejë interesat për borxhin e jashtëm. Interesat e borxhit, përbëjnë të vetmet pagesa në këtë kategori, pasi statistikët bankarë tregojnë se, këtë vit nuk ka pasur riatdhesim të fitimeve prej investimeve direkte. Rezultati neto i këtyre transaksioneve është pozitiv me 77 milionë dollarë amerikanë dhe i dedikohet të ardhurave të larta nga emigrantët sezonalë.

Transferrat e larta korente, kanë mbuluar mbi 80 për qind të defikutit tregtar të mallrave. Ato mbeten zëri kryesor financues brenda llogarisë korente. Ecuria e këtyre transfertave ka luajtur një rol përcaktues në zhvillimet e situatës në sektorin e jashtëm, gjatë vitit 1998. Në sajë të rritjes së tyre, në gjysmën e dytë të vitit u krijua një sufiçit korent i mjaftueshëm për të mbuluar defikitin e transaksioneve të tregtisë së jashtme. E veçantë është se gjatë vitit 1998, ka ndodhur një rigjallërim i fuqishëm i transfertave shtetërore kryesisht në mallra dhe asistencë teknike. Kjo i dedikohet dy faktorëve:

së pari, pas krizës së vitit të kaluar komuniteti ndërkombëtar i kushtoi një vëmendje të veçantë rritjes së besimit të humbur tek institucionet;

së dyti, ardhja e refugjatëve kosovarë në Shqipëri induktoi ndihma humanitare, të cilat janë regjistruar si transferta shtetërore.

Dërgesat e emigrantëve në formën e transfertave korente kanë arritur një shifër rekord për periudhën e tranzicionit, rreth 452 milionë dollarë. Këto transferta u rritën në mënyrë të ndjeshme veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Rritja në hyrjet valutore nga ky burim ishte diçka e pritshme pas shkrirjes së kursimeve në skemat piramidale dhe vitit shumë të vështirë 1997. Megjithatë, kjo rritje e madhe në dërgesat e emigrantëve kapërcen çdo parashikim të bërë në fillim të vitit qoftë edhe ata më optimistët<sup>12</sup>. Këto

---

<sup>12</sup> Situata e vështirë e vitit 1997 mund të ketë ndikuar shpërndarjen në kohë të këtyre transfertave. Për rrjedhim dërgesat e vitit 1997 mund të jenë shtyrë në kohë (në pritje të një situatë më të qetë) për vitin 1998. Nuk përjashtohet mundësia që, në këtë vlerësim të mund të përfshihen, gjithashtu, të ardhurat nga aktivitetet ilegale e të jashtëligjshme.

transferta kanë hyrë në Shqipëri në formën e *cash*-it dhe, në përgjithësi, kanë qarkulluar jashtë sistemit bankar duke nxitur rritjen konsumit dhe të importit. Sipas statistikave vlerësohet që rreth 57 për qind e këtyre hyrjeve në mjete valutore ka qarkulluar jashtë sistemit bankar, ndërkohë që vetëm 43 për qind e këtij fluksi ka prekur sportelet e bankave në formën e transfertave përmes sistemit bankar, apo duke u thithur nga bankat në treg<sup>13</sup>. Një situatë e tillë e bën mjaft të vështirë kontrollin dhe orientimin e këtyre burimeve në shërbim të politikave favorizuese për sektorin e jashtëm. Është shumë e vështirë të thuhet se si do të vazhdojë sjellja e dërgesave nga emigrantët në të ardhmen, por gjykohet për një nivel të lartë hyrjesh valutore deri në krijimin e një niveli të nevojshëm kursimesh në sektorin familjar.

Një faktor shtesë në rritjen e transfertave korente është edhe kriza në Kosovë. Derdhja e fondeve të ndihmave për popullsinë dhe autoritetet kosovare, në ose për llogari të bankave rezidente, është një formë tjetër transfertash korente. Këto transferta kanë ndikuar në rritjen e mjeteve valutore të sistemit bankar.

Pa dyshim që pas vitit 1997 dhe paqartësive politike gjatë vitit 1998, si dhe krijimit të një situatë tejet të trazuar në rajon, nuk mund të pritet një lulëzim i menjëhershëm i investimeve të huaja në Shqipëri. Për vitin 1998, shifra e investimeve të huaja vlerësohet në 45 milionë dollarë. Një indikator në mbështetje të nivelit të investimeve mund të jetë rritja e rieksperteve nga përpunimi aktiv kundrejt vitit 1997. Megjithatë, statistikave të tregtisë së jashtme dëshmojnë, gjithashtu, rënie në importin e grupmallit makineri e pajisje, prandaj kjo shifër duhet të merret në konsideratë me rezervë.

Financimi i defiçitit korent u sigurua përmes rritjes së detyrimeve financiare ndaj botës. Gjatë vitit 1998 janë disbursuar në total mbi 120 milionë dollarë në formën e kredive, përdorimi i huave nga FMN-ja dhe kredia tregtare. Financuesit kryesorë të Shqipërisë kanë qënë Banka Botërore dhe FMN-ja, Gjermania dhe Italia. Disbursimet e kredive të huaja kanë rritur detyrimet e Qeverisë dhe Autoritetit Monetar pa prekur sektorët e tjerë të ekonomisë. Detyrimet e sistemit bankar kundrejt jorezidentëve janë rritur vetëm për 2.2 milionë dollarë.

Hyrjet e larta valutore në formën e transfertave, investimeve të huaja dhe kredive çuan në rritjen shumë të madhe të mjeteve valutore të sistemit bankar dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë. Pas rënies së theksuar të mjeteve gjatë vitit 1997<sup>14</sup> ishte e natyrshme që të pritej tendenca për rritjen e tyre. Hyrjet valutore në sistemin bankar nga burime jorezidente dhe rritja e depozitave në valutë të rezidentëve pranë sistemit bankar, të ndihmuara

<sup>13</sup> Gjatë dy tremujorëve të fundit është vërejtur rritje në dërgesat (transfertat) përmes sistemit bankar. Megjithatë, e parë në kontekstin e rritjes së përgjithshme, nuk do të thotë medoemos që kjo rritje është një reagim pozitiv kundrejt përpjekjeve të sistemit bankar për tërheqjen e dërgesave të emigrantëve.

<sup>14</sup> Rënia e mjeteve duhet të ketë qënë edhe më e madhe për sektorin shtëpiak, por kjo nuk mund të matet pasi nuk ka statistika të sakta në lidhje me prurjet valutore të publikut në skemat piramidale. Mosmarrja në konsideratë e kësaj shifre është shkaku kryesor për gabime dhe harresa të larta në fund të vitit 1997.

dhe derdhja transfertave në ndihmë të Kosovës<sup>15</sup>, shkaktuan rritjen e mjeteve të sistemit bankar (ky efekt mendohet të jetë i përkohshëm). Këto mjete valutore që përfaqësojnë depozitat e sistemit bankar jashtë, janë të vetmet investime që rezidentët kanë bërë gjatë vitit 1998. Nevoja për të zëvendësuar kursimet valutore të humbura në skemat piramidë gjykohet si shkaku kryesor që ka shtyrë sektorin shtëpiak të rrisë menjëherë kursimet në mjete valutore me rreth 40 milionë dollarë.

Hyrjet e larta valutore, çuan në rritjen e rezervave valutore me 63 milionë dollarë duke krijuar një stok rezervash të mjaftueshëm për të përballuar 4.7 muaj importe<sup>16</sup>. Në dallim nga vitet e mëparshme, rritja e rezervave i dedikohet rritjes së stokut të SDR-së, ndërkohë rezervat në mjete valutore kanë pësuar një rënie të vogël. Zërat e tjerë të rezervës paraqiten pa ndryshime. Disbursimet e kredive, përdorimi i kredive dhe huave nga Fondi Monetar, rritja e depozitave valutore në sistemin bankar dhe arkëtimi i interesave nga investimi i saj (rezervës valutore) përbëjnë shkaqet kryesore për rritjen e stokut të rezervave të Autoritetit Monetar gjatë vitit 1998.

Së bashku me zhvillimet e lartpërmendura viti 1998 u mbyll me një shifër të lartë në zërin gabime dhe harresa, e cila në mungesë të zhvillimeve të jashtëzakonshme politiko-shoqërore apo ekonomike shërben si indikator i ekzistencës së aktiviteteve ilegale.

---

<sup>15</sup> Shih transfertat korente.

<sup>16</sup> I referohemi importit të mallrave dhe shërbimeve.

## **1.6 KURSI KËMBIMIT DHE REZERVA VALUTORE.**

**G**jatë vitit 1998, Leku ruajti qëndrueshmërinë e tij në këmbimin me valutat kryesore. Ai është forcuar në këmbimin e tij me dollarin amerikan dhe dhrahminë greke duke ruajtur pozitat e tij ndaj markës gjermane dhe liretës italiane.

Raporti i lekut me dollarin amerikan është çelur në fillim të vitit në nivelin 150.00, për të arritur nënçmimin maksimal në fund të muajit mars me 163.00 (ose në terma relativë, u nënçmua në masën 8 për qind). Për të mos cënuar objektivin themelor të Bankës së Shqipërisë për vendosjen dhe ruajtjen e stabilitetit të nivelit të çmimeve, u vendos që të ndërhyhej në tregun valutor. Gjatë ndërhyrjes u shitën 12.32 milionë USD, në kartëmonedha me prerje 100 USD të vitit 1996. Kjo sasi rezultoi e mjaftueshme për të plotësuar "urinë" e tregut duke u pasuar nga një vlerësim gradual dhe i qëndrueshëm i kursit të këmbimit të monedhës kombëtare, jo vetëm ndaj dollarit por dhe valutave të tjera kryesore.

Vlerësimi i lekut ndaj GRD, në këtë periudhë, i atribuohet vendimit të autoriteteve greke për zhvlerësimin e monedhës së tyre në mbledhjen e rradhës së Ministrave të Ekonomisë dhe Financës të vendeve të Bashkimit European.

Faktorët sezonalë që lidhen me ciklin e prodhimit vendas dhe lëvizjen e emigracionit, ndikuan që prirja vlerësuese e Lekut të vazhdojë e pandërprerë deri në fund të muajit korrik '98, ku u shënuan nivelet më të larta të vlerësimit të lekut ndaj markës gjermane, dhrahmisë greke dhe liretës italiane. Periudha në vazhdim, deri në fund të vitit është karakterizuar nga një vlerësim i mëtejshëm i lekut kundrejt dollarit, një nënçmim ndaj markës gjermane dhe liretës italiane, dhe një stabilitet në këmbimin kundrejt dhrahmisë greke.

Në vlerë relative, në fund të vitit krahasuar me fillimin e tij, leku është vlerësuar nominalisht ndaj dollarit me 6 për qind, ndaj dhrahmisë greke me 5.04 për qind, ndërsa ndaj markës gjermane dhe liretës italiane është zhvlerësuar me 0.7 për qind.

Disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në stabilizimin e kursit të këmbimit të monedhës kombëtare, janë:

- një politikë e matur monetare, e kombinuar me një politikë të përgjegjshme fiskale;
- norma atraktive interesi që ofruan investimet në monedhë kombëtare, krahasuar me ato në monedhë të huaj;
- rritja e besimit në monedhën e vendit; dhe
- zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

Përsa i takon zhvillimeve me karakter strukturor të tregut të brendshëm të këmbimeve valutore, vërejmë një rritje të konkurrencës nga ana e bankave të nivelit të dytë. Kjo ka ardhur jo vetëm si rezultat i shtimit të numrit të

bankave që operojnë në këtë treg, por edhe nga një rritje e eficiencës së tyre. Lidhur me këtë fakt mund të përmendim ngushtimin e *spread*-it të kuotimeve të tyre si dhe aplikimin prej tyre të kurseve të diferencuara në tregun valutor ndërbankar dhe atë me pakicë. Rritja e konkurrencës së bankave tregtare ka bërë të dukshme humbjen “e shkëlqimit” të tregut paralel. Kambistët po orientohen gjithnjë e më tepër nga bankat, duke i përshtatur kuotimet e tyre të valutave kundrejt lekut, me kuotimet e bankave. Edhe kurset e valutave mes tyre, përcaktohen në të njëjtën mënyrë, po të kemi parasysh se aksesimi në tregun ndërkombëtar valutor është “një monopol” i bankave. Rritja e pranisë së bankave në treg, i ka bërë kambistët më të ndjeshëm ndaj mundësisë së humbjes dhe, njëherazi, ka detyruar shumicën e tyre që të preferojnë ta mbyllin ditën me pozicion valutor neutral. Vlera mesatare e vëllimit javor të transaksioneve valutore, që është realizuar në tregun formal të brendshëm, gjatë gjashtëmujorit të dytë luhatej në kufijtë 7-8 milionë dollarë.

Rezerva valutore<sup>17</sup> e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 1998 është rritur nga 308.28 milionë dollarë, që ishte në fillim të vitit, në 384.22 milionë dollarë në fund të vitit. Tendenca në rritje e rezervës valutore ka qenë e qëndrueshme, pothuaj gjatë gjithë vitit, me përjashtim të fundit të muajit mars. Kjo për arsyen e shitjes së dollarëve për mbrojtjen e kursit të këmbimit të lekut. Në këtë rritje të vlerës së rezervës valutore, kanë ndikuar disa hyrje të mëdha, ku mund të përmendim:

- shtim nga hyrja e IDA me 8.66 milionë USD;
- shtim nga granti i Komunitetit European për 5.51 milionë USD, mbështetje për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
- shtim nga disbursimi i kredive të huaja ku përmendim transhin e parë të marrëveshjes ESAF-2 me FMN për 7.88 milionë USD, dhe IDA me 30.56 milionë USD, mbështetje e Bankës Botërore për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;
- disbursime të kredive të huaja ku veçojmë IDA me 12.53 milionë USD dhe Bashkimi European për 10.90 milionë USD (përmes kredisë së qeverisë greke në masën 3 miliardë dhrahmi).

Ndër faktorët që kanë ndikuar në kah të kundërt të rritjes së nivelit të rezervës valutore mund të përmendim shitjet në muajt mars dhe prill gjatë ndërhyrjes për mbrojtjen e kursit të këmbimit të lekut, pagesat për shërbimin e borxhit të Qeverisë, transferimet e ndryshme sipas kërkesave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për fondet në favor të saj.

Niveli i rezervës valutore në fund të vitit, ka qenë mbi nivelin e akorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar prej 375.00 milionë dollarë. Në përpjekje për t’ju afruar këtij kufiri, Banka e Shqipërisë shiti valutë, por vlerat e realizuara, duke mbajtur parasysh qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të Lekut, ishin minimale në shumën 2.33 milionë dollarë. Për më tepër ky

---

<sup>17</sup> Është përfshirë dhe efekti i rivlerësimit të kursit të këmbimit.

moment ka koinçiduar me një prani të konsiderueshme të bankave tregtare në tregun valutor, në përpjekje për të mbyllur pozicionet e tyre të hapura valutore (normat e vendosura nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë).

Gjatë vitit 1998, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, miratoi politikën e re të administrimit të rezervës valutore si edhe Manualin e Operacioneve Monetare. Këto dokumente janë me rëndësi në krijimin e një kuadri të plotë ligjor që rregullon mënyrën e investimit të rezervës valutore, mënyrën e evidentimit dhe ndjekjes së saj, përbërjen sipas valutave, kohëzgjatjen e investimit si dhe tipet e instrumenteve që përdoren në këtë investim. Në të njëjtën kohë, Manuali i Operacioneve Monetare, përshkruan në mënyrë të detajuar veprimet që kryhen në Departamentin e Operacioneve Monetare në rastin e transaksioneve valutore, të tregut të brendshëm të parasë, të llogarisë së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, etj.

Ndonëse kursi i këmbimit është një tregues derivat, edhe gjatë vitit 1999, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të monitorojë, në mënyrë të kujdesshme, ecurinë e kursit të këmbimit të lekut, për të evituar tendenca të ndryshme spekulative dhe cënimin e objektivit kryesor të saj, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Gjatë vitit 1999, parashikohen hyrje të reja fondesh, ku përmendim transhin e marrëveshjes ESAF-2 të akorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Një pjesë e tyre, nëse paraqitet e nevojshme, do të përdoren për garantimin e stabilitetit të kursit të këmbimit të lekut, duke synuar njëherazi mbajtjen e nivelit të rezervës në kufijtë e katër muajve importe. Ndonëse niveli i normës së interesit për investimin e rezervës valutore, gjatë 1999, parashikohet më i ulët se gjatë vitit 1998, të ardhurat nga investimi i rezervës parashikohen të qëndrueshme. Ndikimi negativ i rënies së normës mesatare të interesit, do të kompensohet nga rritja e vlerës së investuar.

## **2. ZHVILLIMET MONETARE**

### **2.1 POLITIKA MONETARE E NDJEKUR NGA BANKA E SHQIPËRISË.**

**N**ë funksion të përmbushjes së objektivit të saj themelor: ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, edhe gjatë vitit 1998 Banka e Shqipërisë ka vazhduar të ndjekë një politikë të matur e relativisht të shtrënguar monetare duke ruajtur kontrollin mbi ofertën e parasë.

Inflacioni në nivel vjetor nga 42.1 për qind që ishte në fund të vitit 1997, pothuajse u përgjysmua në fund të muajit qershor duke arritur në 17.8 për qind, ndërsa në fund të vitit arriti 8.7 për qind, duke qenë nën objektivin e programuar prej 10 për qind.

Rënia e inflacionit në këto nivele, i krijoi mundësi Bankës së Shqipërisë të zvogëlonte normat e interesit për depozitat disa herë gjatë kësaj periudhe, duke i çuar ato, në fund të vitit, në nivelin 16.5 për qind për të tre maturitetet. Është e rëndësishme të theksohet se, megjithë ndryshimet e bëra, këto norma aktualisht janë përsëri pozitive në terma realë.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet ruajtjes së normës reale të interesit në nivele pozitive, ka synuar garantimin e një shume të mjaftueshme në kthim, e cila nga ana e saj, do të siguronte nivele të kënaqshme të kursimeve të publikut.

Vënia nën kontroll e inflacionit kontribuoi edhe në forcimin e vlerës së Lekut. Në kushtet e një situatë të favorshme joinflacioniste në vend, politika monetare e zbatuar, ka synuar të ndihmojë rritjen e ekonomisë, uljen e deficitit buxhetor, dhe në të njëjtën kohë ka treguar kujdes edhe për sektorin e jashtëm të ekonomisë, pra në përgjithësi për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit.

Niveli më i ulët i deficitit buxhetor gjatë këtij viti, çoi edhe në uljen e kërkesës për para nga ana e sistemit bankar. Në të njëjtën kohë, defikiti më i ulët buxhetor, i krijoi mundësi Bankës së Shqipërisë të caktonte kufij më të lartë krediti për bankat, për të nxitur kreditimin e sektorit privat si dhe për të ulur koston e dhënies së kreditit për këtë sektor. Kështu, stoku i kredisë në fund të vitit ishte rreth 12 për qind mbi nivelin e fundit të vitit të kaluar, ndërkohë që pjesa e kredisë të sektorit privat u rrit me mbi 14 për qind. Megjithë, uljen e përqindjes së interesit nga ana e Bankës së Shqipërisë, nivelet e kreditit të akorduar, nuk u arritën të realizoheshin nga bankat e nivelit të dytë.

Pjesë përbërëse e kuadrit makroekonomik, është edhe programi monetar që harton çdo vit Banka e Shqipërisë, ku përcaktohet në fillim të çdo viti rritja e ofertës së parasë, që është agregati më i gjerë e kryesor monetar.

Kështu, sipas këtij programi, përcaktohej një rritje e parasë gjithsej në masën rreth 23 për qind deri në fund të vitit. Aktualisht, rritja e parasë gjithsej në fund të vitit është 20.7 për qind (në nivel vjetor). Megjithatë, kjo rritje mendojmë se i është përgjigjur jo vetëm nevojave të Qeverisë për

financimin e deficitit buxhetor, por edhe nevojave të ekonomisë (kryesisht, sektorit privat) për zgjerimin e aktivitetit kreditues.

Me përfundimin me sukses të programit të emergjencës brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 1998, dhe në vijim të punës për stabilizimin e mëtejshëm të ekonomisë në tërësi, Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim edhe me organizmat ndërkombëtarë hartuan, në muajin maj, një program zhvillimi afatmesëm. Realizimi i këtij programi do të mbështetet nga marrëveshja ESAF-2 me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e nënshkruar po në këtë periudhë.

Sipas këtij programi, Banka e Shqipërisë, në përputhje edhe me përgjegjësitë e saj ligjore, ka ndjekur ecurinë e tre objektivave sasiore.

**Rezervat valutore neto të Bankës së Shqipërisë** në fund të muajit dhjetor 1998 kanë rezultuar me rreth 5 milionë dollarë mbi objektivin e poshtëm të vendosur për to në program. Rritja e tyre ka ardhur kryesisht nga fondet valutore të ardhura nga vendet donatore për mbështetjen e deficitit buxhetor të këtij viti. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë, pa prekur aspak nivelin e rezervave valutore të saj, për të plotësuar nevojat e bankave të nivelit të dytë, ka kryer edhe një sërë transaksionesh valutore dhe ka ndërhyrë lehtë në treg (kryesisht shitje valute).

Për **mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë**, është vendosur një kufi, i cili në njëfarë mënyre pasqyron një objektiv për paranë në qarkullim. Gjatë vitit (ashtu si dhe më parë), ky objektiv ka qenë poshtë kufirit të sipërm të vendosur për të - rezultat i rënies së konsiderueshme të parasë jashtë bankave -.

Kthimi i parasë përsëri në sistemin bankar tregon jo vetëm për rritjen e nivelit të besueshmërisë së publikut ndaj bankave, por edhe për nivelin e lartë e atraktiv të interesit që kanë patur depozitat gjatë këtij viti, sidomos ato me afat në lekë. Nga ana tjetër, duhet thënë se vazhdojnë të ekzistojnë vështirësi edhe në gjetjen e alternativave të tjera të investimit, në kushtet e një tregu jo të zhvilluar të parasë.

Edhe objektivi i **kredisë neto të sistemit bankar për Qeverinë** ka qenë nën kufirin e sipërm të vendosur për të. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor në fund të vitit është plotësisht në kufirin e 28.9 miliardë lekëve dhe u realizua nëpërmjet kredisë së dhënë kryesisht nga bankat tregtare dhe nga Banka e Shqipërisë.

## **2.2 OFERTA E PARASË.**

Në fund të muajit dhjetor, paraja gjithsej<sup>18</sup> (M3) është rritur rreth 21 për qind (në nivel vjetor). Mjetet e brendshme neto kanë kontribuar në masën 13 pikë përqindje, ndërsa pjesa tjetër (8 pikë përqindje) është tërësisht nga ndryshimet e rritjes së pozicionit valutor neto të sistemit bankar. Ashtu si dhe në vitet e tjera, krediti për Qeverinë domethënë, defiçiti buxhetor, vazhdon të mbetet përcaktuesi kryesor në rritjen e ofertës monetare.

Duke analizuar komponentët përbërës të ofertës së parasë, vihen re ndryshime me kahje të kundërt.

Kështu, paraja jashtë bankave është zvogëluar me 4.4 miliardë lekë, ndërsa depozitat pa afat në lekë janë ulur me rreth 3.27 miliardë lekë. Ndërkaq, depozitat me afat në lekë janë rritur me rreth 45 miliardë lekë, kryesisht në dy bankat tona shtetërore. Ky kthim drejt depozitave më afatgjata, përveçse tregon për rritjen e konfidencës së publikut në sistemin bankar, pasqyron njëkohësisht nivelin e ulët të aktivitetit ekonomik të vendit dhe inefiçencën e tregut financiar. Kjo provohet edhe nga sjellja e individëve kundrejt uljes së herëpashershme të interesave.

Përsa i takon agregatit M1, mund të themi që elementet përbërëse të tij kanë patur një ecuri në rënie gjatë gjithë vitit të kaluar.

Paraja jashtë bankave nga 36.6 për qind që zinte në totalin e parasë gjithsej në fund të vitit 1997, ka arritur në 28 për qind deri në fund të vitit. Kjo është reflektuar edhe në rënien e raportit para jashtë bankave ndaj totalit të depozitave, i cili ka arritur në nivelin e tij më të ulët të regjistruar për këtë vit. Ky raport nga 57.8 për qind që ishte në fund të muajit dhjetor 1997 ka rënë në 40 për qind në fund të vitit. Kjo tregon preferencën për mbajtjen e parave në depozita, dhe jo në "cash".

Kontributin kryesor në rritjen e ofertës së parasë e ka dhënë agregati M2, i cili në fund të vitit u rrit 23 për qind. Tendencia në rritje e agregatit M2, është rezultat i rritjes së madhe të depozitave me afat në lekë. Gjatë vitit 1998, depozitat me afat në lekë janë rritur mesatarisht rreth 4 miliardë lekë çdo muaj. Në këtë rritje, peshën më të madhe e kanë zënë depozitat me afat tremujor të cilat kanë një rritje mesatare mujore rreth 2.5 miliardë lekë. Këto shifra tregojnë që rritja e depozitave me afat tremujor zë rreth 60 për qind të rritjes totale mujore të depozitave me afat.

---

<sup>18</sup> Të dhënat janë paraprake.

**Tabela 7. Agregatet monetare (në milionë lekë; fundi i periudhës).**

|                                  | 1992   | 1995    | 1996    | 1997    | 1998    |
|----------------------------------|--------|---------|---------|---------|---------|
| Paraja jashtë bankave            | 9,897  | 41,906  | 47,814  | 72,726  | 68,323  |
| Depozita pa afat                 | 7,266  | 17,346  | 42,591  | 18,941  | 15,666  |
| Agregati M1                      | 17,163 | 59,252  | 90,405  | 91,667  | 83,990  |
| Depozita me afat                 | 4,764  | 28,117  | 30,240  | 70,554  | 115,497 |
| Agregati M2                      | 21,927 | 87,370  | 120,646 | 162,221 | 119,487 |
| Depozita në valutë               | 6,844  | 20,080  | 33,906  | 36,326  | 40,243  |
| Agregati M3                      | 28,771 | 107,449 | 154,552 | 198,547 | 239,730 |
| Paraja jashtë bankave në % të M1 | 57.7   | 70.7    | 52.9    | 79.3    | 81.3    |
| Paraja jashtë bankave në % të M3 | 34.4   | 39.0    | 30.9    | 36.6    | 28.5    |
| Depozita pa afat në % të M1      | 42.3   | 29.3    | 47.1    | 20.7    | 18.7    |
| Depozita pa afat në % të M3      | 25.3   | 16.1    | 27.6    | 9.5     | 6.5     |
| Agregati M1 në % ndaj M3         | 59.7   | 55.1    | 58.5    | 46.2    | 35.0    |
| Depozita me afat në % të M2      | 21.7   | 32.2    | 25.1    | 43.5    | 57.9    |
| Agregati M2 në % të M3           | 76.2   | 81.3    | 78.1    | 81.7    | 83.2    |
| Depozita në valutë në % të M3    | 23.8   | 18.7    | 21.9    | 18.3    | 16.8    |
| Agregati M3 = 100 %              | 100.0  | 100.0   | 100.0   | 100.0   | 100.0   |

**Burimi: Banka e Shqipërisë.**

Kontributi i individëve në depozitat në valutë, ka rënë në 32 për qind në fund të vitit 1998, krahasuar me 40 për qind të regjistruar në vitin e mëparshëm, duke reflektuar preferencën e individëve për të mbajtur kursimet e tyre në monedhën e vendit.

Kjo preferencë, ka krijuar likuiditete të nevojshme (sidomos në Bankën e Kursimeve) të cilat në një masë të madhe janë përdorur për të financuar huamarrjen e brendshme të Qeverisë (huamarrja në sektorin privat ka qenë në nivele të ulëta).

Gjatë këtij viti edhe bankat private dhe ato me kapital të përbashkët, kanë bërë progres në drejtim të thithjes së depozitave në valutë dhe tregjeve të huasë në Shqipëri, si dhe në drejtim të biznesit në Lekë, të cilin Banka e Shqipërisë kërkon ta shohë në vazhdimësi. Ky interes nga ana e bankave private është pjesërisht interes për vetë bankën, pasi stabiliteti i Lekut ka çuar në një zvogëlim të pjesës që zënë depozitat në valutë në totalin e depozitave të sistemit bankar. Në të njëjtën kohë, qëndrueshmëria e Lekut ka zvogëluar riskun e tyre, nisur nga fakti se huamarrësit nuk janë të ekspozuar nëse kursi i këmbimit, çmimet apo normat e interesit mund të ndryshojnë nga faktorë të paparashikuar.

**Tabela 8. Shpejtësia e parasë (në herë).**

|                     | 1992 | 1993 | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 |
|---------------------|------|------|------|------|------|------|------|
| Shpejtësia e parasë |      |      |      |      |      |      |      |
| Agregati M1         | 2.9  | 4.4  | 4.8  | 3.9  | 3.1  | 3.7  | 5.5  |
| Agregati M2         | 2.3  | 3.1  | 3.2  | 2.6  | 2.3  | 2.2  | 2.3  |
| Agregati M3         | 1.7  | 2.5  | 2.6  | 2.1  | 1.8  | 1.7  | 1.9  |

**Burimi: Banka e Shqipërisë.**

Depozitat në valutë, ndryshe nga gjashëmujori i parë, kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme dhe me tendencë në rritje gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1998. Gjatë gjithë vitit në shqyrtim, ato u rritën me 11 për qind, ku peshën më të madhe e zënë individët. Edhe tendenca në rënie që u vu re për sektorin privat në gjashëmujorin e parë, është kthyer në kah të kundërt gjatë gjashtëmujorit të dytë.

### 2.3 INSTRUMENTET FINANCIARE.

**B**anka e Shqipërisë vëmendje të veçantë i ka kushtuar efektivitetit të politikës monetare nëpërmjet një lidhjeje të qëndrueshme midis objektivit final dhe instrumenteve që përdoren për arritjen e tyre. Kjo gjë kushtëzohet nga vetë situata dhe kushtet aktuale të zhvillimit të sistemit tonë financiar, si dhe për të evituar çdo pengesë që mund të krijojnë instrumentet direkte në zhvillimet dhe konkurrencën e lirë midis bankave.

Në kushtet e një tregu jo shumë të zhvilluar të parasë dhe kapitaleve, dhe në kuadrin e përpjekjeve për krijimin e një terreni të përshtatshëm për evoluimin e instrumenteve indirekte, Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 1998, është mbështetur në përdorimin e harmonizuar të instrumenteve direkte dhe indirekte të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka vepruar direkt nëpërmjet fuqisë së saj rregullatore dhe indirekt nëpërmjet influencës së saj në kushtet e tregut të parasë si emetuese e parasë, duke ndikuar kështu në kushtet e kërkesës dhe ofertës për para.

Gjatë vitit 1998, Banka e Shqipërisë ka bërë ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor dhe në mënyrën e funksionimit të instrumenteve të saj të politikës monetare.

#### 2.3.1 Normat e interesit.

Banka e Shqipërisë ka përdorur përqindjet minimale të interesit të depozitave për bankat me kapital shtetëror, si një mekanizëm të përshtatshëm transmissi të politikës monetare, duke kombinuar ndikimin administrativ me atë të tregut dhe duke patur si parim kryesor ruajtjen e interesit në terma realë pozitivë. Nëpërmjet kësaj politike ajo ka synuar që të ruajë dhe të rrisë sigurinë e publikut rreth vlerës së Lekut.

**Tabela 9. Përqindjet e interesit (fondi i periudhës; vjetore, në %).**

|                                                        | 1993 | 1996 | 1997 | 1998 |
|--------------------------------------------------------|------|------|------|------|
| Përqindja rifinancimit                                 | 34.0 | 24.0 | 31.0 | 22.9 |
| Përqindjet e depozitave 1/<br>12-M                     | 23.0 | 19.1 | 27.8 | 16.5 |
| Përqindjet e kredisë 2/<br>12-M                        | 30.0 | 28.8 | 43.0 | 25.0 |
| Përqindja e letrave me vlerë<br>Bono thesari 3/<br>3-M | ...  | 21.1 | 35.3 | 19.9 |
| 6-M                                                    | ...  | 22.3 | 34.5 | 21.4 |
| 12-M                                                   | ...  | 22.5 | 35.0 | 22.9 |

**Burimi: Banka e Shqipërisë.**

1/ Para tetorit '95 interesi i depozitës tregon nivelin minimum të bandës së vendosur nga Banka e Shqipërisë. Nga tetori '95 interesi i depozitës tregon mesataren e ponderuar për depozitat e reja me maturim dymbëdhjetë muaj.

2/ Para tetorit '95 interesi i kredisë tregon përqindjen kufi të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Nga tetori '95 interesi i kredisë tregon mesataren e ponderuar për kreditë e reja me maturim dymbëdhjetë muaj.

3/ Interesi mesatar i ponderuar i ofertave të pranuar në ankandin më të fundit të bonove të thesarit për periudhën.

Në gjysmën e parë të vitit, politika e përkohshme që u ndoq në këtë drejtim, nëpërmjet rritjes më të madhe të normës së interesit për depozitat afatshkurtra, e dha efektin e saj pozitiv në drejtim të kthimit të besimit të publikut në sistemin bankar në kushtet e mungesës së alternativave të tjera investuese. Por, nga ana tjetër, bankat u rënduan nëpërmjet rritjes së kostos së ndërmjetësimit, duke u reflektuar kjo edhe në rritjen e *yield*-it të bonove të thesarit, çka rëndon shpenzimet e buxhetit të shtetit. Konkretisht, gjatë gjashtëmujorit të parë, niveli i interesave për depozitat u ndryshua dy herë në periudhën maj-qershor, duke u ulur me 4, 4 dhe 5 pikë përqindjeje, respektivisht për depozitat tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore.

Pas arritjes së qëllimit nëpërmjet kësaj politike, në gjysmën e dytë të vitit në përputhje me zhvillimet monetare si dhe ecurinë e inflacionit, Banka e Shqipërisë për të ruajtur kapacitetin thithës të sistemit bankar si dhe për të stimuluar kreditimin e mëtejshëm të ekonomisë, kaloi në zbutjen e diferencimeve dhe në uljen graduale të nivelit të interesave për depozitat me afat në lekë për të tre maturitetet (tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore). Në fund të vitit këto norma ishin 16.5 për qind për të tre llojet e depozitave.

Nga ana tjetër, ndryshimet në përqindjet e interesave për depozitat me afat në lekë, ndikuan edhe në rënien e interesit mesatar të bonove të thesarit dhe interesit të kredive, duke lehtësuar kështu sistemin bankar nga një kosto relativisht e lartë dhe duke i shërbyer edhe uljes së kostos së investimeve në ekonomi.

### **2.3.2 Rifinancimi, Kredia Lombard dhe REPO.**

Për të përmirësuar efektivitetin e instrumenteve të kreditit, në muajin gusht, nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë u miratuan rregulloret e përmirësuara të instrumenteve të kreditit (Marrëveshja e Riblerjes dhe ajo e Anasjelltë e Riblerjes, kredia e Rifinancimit dhe kredia Lombard) që përfshijnë përcaktime në përkufizimin e tyre, në vendosjen e kolateralit, limitin e kreditimit, normat e interesit, gjrobat dhe afatet e tyre të maturimit. Me përmirësimet përkatëse për secilin instrument synohet, jo vetëm plotësimi në mënyrë optimale i nevojave për likuiditete dhe përmirësimi i menaxhimit të këtyre, por dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar të bonove të thesarit e, veçanërisht, krijimi i kushteve të përshtatshme për funksionimin e tregut sekondar.

Fakti, që marrëveshjet e riblerjes kanë intensitetin më të madh krahasuar me instrumentet e tjera të kredisë që sigurojnë apo plotësojnë mungesat e likuiditetit për periodha afatshkurtra, i bën ato të cilësohen si kredi e parë e dhënë nga Banka e Shqipërisë.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit janë përdorur në mënyrë të konsiderueshme marrëveshjet e riblerjes midis bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë në formën e investimit në letra me vlerë të qeverisë. Duhet theksuar se këto marrëveshje janë realizuar me iniciativën e bankave tregtare. Në kushtet e likuiditetit të tepërt në sistem, marrëveshjet e riblerjes janë kryer me synim thithjen e likuiditetit dhe nxitjen e aktivizimit të pjesëmarrësve në tregun ndërbankar. Ky instrument i ka

shërbyer menaxhimit në mënyrë të kujdesshme dhe më fleksibël të pozicioneve të likuiditetit të bankave tregtare.

Në rastin tonë, kur nuk ekziston një treg sekondar i zhvilluar dhe synohet nxitja dhe përmirësimi i tij, roli i Bankës së Shqipërisë në përputhje dhe me objektivat e saj duhet të jetë një rol rregullator, që në këtë rast do të thotë se ajo do të lidhë marrëveshje REPO me bankat e nivelit të dytë vetëm kur këto të fundit kanë ezauruar të gjitha mundësitë që u ofron tregu ndërbankar dhe ai sekondar. Forcimi i tregut sekondar të bonove të thesarit, nga ana e vet, do të jepte efekte pozitive në rritjen e numrit të pjesëmarrësve në tregun primar e, gjithashtu, në normat e interesit për të cilat duhet të vendosë ky treg.

Me qëllim që të stimulohen dhe të inkurajohen bankat për të menaxhuar nevojat e tyre për likuiditete së pari në tregun ndërbankar, e më pas nëpërmjet REPO-ve, Rifinancimit e Lombardit, është menduar që kredia Lombard duhet të ketë një normë interesi më të lartë se tregu, ndonëse gjatë këtij viti nuk janë përdorur asnjëherë.

Si përfundim mund të themi se situata e mirë e likuiditeteve në sistemin bankar u reflektua në mospërdorimin e instrumenteve kredituese të Bankës së Shqipërisë.

### **2.3.3 Rezerva e Detyrueshme.**

Rezerva e detyrueshme është një instrument i cili është zbatuar për herë të parë në vendin tonë në vitin 1992 dhe që nga ajo kohë nuk ka ndryshuar dhe nuk është rishikuar. Në këtë mënyrë ky instrument ka luajtur një rol pasiv në politikën monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, duke mos kryer disa nga funksionet e tij, pasi kryesisht është përdorur nga Banka e Shqipërisë për të mbrojtur bankat nga ndonjë krizë likuiditeti e paparashikuar dhe depozituesit nga ndonjë falimentim i mundshëm i bankave.

Për të rritur fleksibilitetin dhe operativitetin e përdorimit të këtij instrumenti, Banka e Shqipërisë, bëri ndryshime në metodikën e llogaritjes së tij. Megjithatë, niveli i rezervës së detyrueshme vazhdon të jetë 10 për qind i totalit të depozitave të bankave në lekë dhe në valutë dhe nuk është remuneruar.

Për vendet me një sistem financiar jo shumë të zhvilluar, siç është vendi ynë, ku tregu ndërbankar është fillestar dhe ku vonesat dhe mangësitë e sistemit të kleringut krijojnë lëkundje të ndjeshme në nivelin e rezervave të bankave, është menduar që rezerva e detyrueshme të mbahet si një mesatare e pozicioneve ditore të bankave të nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1998, Banka e Shqipërisë futi regjimin e ri të mobilizimit të rezervës së detyrueshme në lekë deri në 5 për qind të nivelit të saj, për të gjitha bankat e nivelit të dytë. Pra, rezerva e detyrueshme tashmë krahas funksioneve të saj primare shërben dhe si një

amortizator likuiditeti për administrimin ditor të *cash*-it të bankave si dhe për kryerjen e një sërë pagesave ditore ndërbankare.

Gjithashtu, për të mënjeluar pozicionet e hapura valutore të bankave, të rrjedhura nga konvertimi i valutave të tjera në dollarë amerikanë për plotësimin e rezervës së detyrueshme, Banka e Shqipërisë vendosi të ndryshojë mënyrën e mbajtjes së rezervës së detyrueshme në valutë, në katër valuta kryesore: dollarë amerikanë, marka gjermane, lireta italiane dhe dhrahmi greke. Ndonëse shkalla e shfrytëzimit të mobilizimit të rezervës ka qenë e ulët, ndryshimet në përgjithësi në drejtim të përmirësimit të këtij instrumenti e kanë bërë atë më fleksibël.

### **2.3.4 Kufiri i Kreditit.**

Banka e Shqipërisë ka shpërndarë në gjashtëmujorin e parë të vitit rreth 2 miliardë lekë kufi krediti për bankat. Ndonëse kufiri i kreditit i akorduar nga Banka e Shqipërisë për vitin 1998 ka qenë sa dyfishi i atij të vitit 1996 dhe gati sa trefishi i kufirit të kreditit të shpërndarë në vitin 1997, ai vazhdon të zërë një përqindje modeste në totalin e kredisë së brendshme për ekonominë.

Si rezultat i rritjes së kredive të pakthyera në afat, sidomos në bankat shtetërore, në 13 shkurt 1998, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendim që “bankat e nivelit të dytë mund të marrin kufi krediti, vetëm në qoftë se kreditë e pakthyera në afat janë nën 20 për qind të gjendjes së kredisë gjithsej” dhe “Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare lejohen të japin kredi vetëm për të pastrehët dhe për Ujësjetësin e Bovillës të cilat garantojnë dhe financohen nga buxheti i shtetit”. Në këto kushte për vitin 1998 nuk u është shpërndarë kufi krediti këtyre bankave si dhe bankës Dardania.

Edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1998, masa e kreditit vazhdoi të kontrollohet përsëri nëpërmjet kufirit të kreditit, i cili është aplikuar për çdo bankë mbi bazën e kredisë neto për ekonominë. Ndërkohë, për bankat me kapital tërësisht shtetëror ka vazhduar përsëri situata e moslejimit të zhvillimit të aktiviteteve kredituese si pasojë e nivelit akoma të lartë të kredive me probleme ndaj tepricës gjithsej të kredisë. Ky ishte një faktor tjetër kryesor i cili ndikoi, pa dyshim, në uljen e realizimit të kufirit të kreditit për gjithë vitin 1998, duke patur parasysh dhe faktin që këto banka kanë një shtrirje në gjithë territorin e vendit.

Theksojmë se instrumenti i kufirit të kreditit tregon se nuk është bërë pengesë për aktivitetin kreditues të sistemit bankar dhe për mbështetjen e investimeve në ekonomi. Ndërkaq, nënvizojmë se, në njëfarë shkalle edhe niveli relativisht i lartë i normave të interesit për kreditë që zbatojnë bankat ka patur ndikimin e vet në aftësitë e ekonomisë e të biznesit privat për të thithur mundësitë kredituese të sistemit bankar.

Banka e Shqipërisë ka rishikuar kufirin e kreditit çdo tremujor në përputhje me zhvillimet monetare dhe bazuar në ecurinë e treguesve monetarë për

çdo bankë në veçanti, duke ia përshtatur vetë nevojave të bankave nga njëra anë dhe arritjes së objektivit final të saj, nga ana tjetër.

Duhet thënë që bankat e nivelit të dytë kanë patur në dispozicion dhe mundësi të tjera për zgjerimin e kufirit të tyre të kreditit, duke iu drejtuar tregut ndërbankar nëpërmjet tregtimit të kufirit të kreditit, burim të cilin ato nuk kanë arritur ta përdorin.

### **3. SISTEMI BANKAR**

#### **3.1 LEGJISLACIONI DHE KUADRI RREGULLATOR.**

Gjatë vitit 1998, kuadri ligjor dhe ai rregullator mbi bazën e të cilit funksionon sistemi bankar në Shqipëri, regjistroi zhvillime cilësore ndër të cilat më të spikaturit janë:

Së pari, sanksionimi i pavarësisë së Bankës së Shqipërisë në Kushtetutën e miratuar në muajin nëntor 1998, e cila në nenin 161 i njeh Bankës së Shqipërisë funksionet e saj kryesore:

i- Të drejtën ekskluzive për nxjerrjen dhe qarkullimin e monedhës shqiptare; ii- të drejtën për të zbatuar në mënyrë të pavarur politikën monetare të shtetit shqiptar; iii- të drejtën për të mbajtur dhe administruar rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë.

Së dyti, ligji i ri “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” përcakton saktë: sanksionet respektive për subjektet që kryejnë veprimtari bankare ose grumbullojnë depozita nga publiku pa licencë; rregullat e mbikëqyrjes bankare; masat dhe sanksionet administrative; dispozita të reja për ushtrimin e veprimtarisë bankare nga degët e bankave të huaja; konceptet se çfarë quhet “bankë”, “veprimtari bankare”, “kujdestari” dhe “likuidim i një banke”.

Në këtë pjesë të ripunuar të legjislacionit u morën në konsideratë Parimet Kryesore të Mbikëqyrjes Bankare të Komitetit të Baselit.

**Ushtrimi i veprimtarisë bankare** - Ligji i ri përcakton qartë kryesisht se cilat janë procedurat për të ushtruar veprimtari bankare, dhe më tej ngarkon Bankën e Shqipërisë me të drejta të plota për të licencuar dhe mbikëqyrur këto veprimtari bankare. Në këtë kuadër, ligji paraqet një grup kriteresh më serioze që kanë të bëjnë me reputacionin, objektivat kryesore, transparencën, kapacitetin intelektual dhe profesional të drejtuesve etj.

Sipas ligjit të ri, Banka e Shqipërisë vlerëson, rast pas rasti, të gjitha elementet dhe procedurat e licencimit që duhet të plotësohen në mënyrë të plotë për të gëzuar të drejtën për të vepruar si bankë nga çdo aplikues.

**Veprimtaria bankare** - Lista e veprimtarive bankare të lejuara është e mjaftueshme për të mbuluar gjithë veprimtaritë e tanishme të ndërmarra nga bankat në Republikën e Shqipërisë, dhe lejon një biznes bankar të dobishëm dhe të sigurtë në kontekstin e kësaj ekonomie. Sidoqoftë, Banka e Shqipërisë është në gjendje të autorizojë ndërmarrjen e veprimtarive të tjera që janë ose mund të bëhen praktika të zakonshme bankare në tregjet ndërkombëtare.

**Kërkesat mbi Kapitalin dhe Rregulloret e Mbikëqyrjes** - Ligji i ri i jep Bankës së Shqipërisë kompetenca të mjaftueshme për t'u kërkuar bankave të mbajnë kapital dhe rezerva cilësore, të pacënuara, si dhe një minimum

shume kapitali për t'u paguar, që do të përshtaten nga Banka e Shqipërisë herë pas here.

**Struktura Administrative dhe Përgjegjësia** - Sipas ligjit, këshilli drejtues mban përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarive të një banke. Gjithashtu, ai u kërkon bankave që të kenë një komitet kontrolli, si një strukturë të veçantë mbikëqyrjeje, të përbërë nga disa persona që emërohen nga mbledhja e përgjithshme e aksionerëve. Përveç kësaj, kërkohet publikimi i informacionit për aksionerët, zotëruesit e letrave me vlerë të borxhit dhe depozituesit e bankës.

**Masat Administrative dhe Sanksionet** - Sanksionet kundrejt shkeljeve të ligjit dhe masat administrative janë shkallëzuar arsyeshëm për t'u zbatuar për tipe të ndryshme të kundravajtjeve, dhe pengojnë drejtimin e veprimtarive joligjore. Ato ndryshojnë që nga paralajmërimet me shkrim në rastet e shkeljeve të vogla deri tek revokimi i licencës bankare për shkelje më serioze, pa shmangur zbatimin e dispozitave penale të parashikuara në Kodin Penal.

**Kujdestaria dhe Likuidimi** - Ligji i jep të drejtën Bankës së Shqipërisë të emërojë një kujdestar për të marrë në zotërim kontrollin mbi drejtimin e bankës, si pjesë e masave administrative. Ky do të ketë fuqinë të veprjë mbi bankën dhe të përshtatë ose rekomandojë masat e nevojshme për të rivendosur bankën në kushte financiare të shëndosha.

Nga sa më sipër, kuptohet se rëndësi të veçantë merr: (a) klasifikimi instrumenteve mbikëqyrëse; (b) aplikimi i normës së aktiveve me rrezik; (c) shpejtësia për një likuidim të rregullt aty ku ekziston një kapital i mjaftueshëm dhe i vlefshëm për të absorbuar pretendimet e kreditorëve; (d) vlerësimi i shpejtë i shumës efektive të kapitalit të mbetur në një bankë kur ka tregues se shkalla e mjaftueshmërisë së kapitalit të saj mund të jetë keqësuar dukshëm; (e) aftësia mbijetuese financiare dhe institucionale e një banke.

Përsa i takon anës rregullatore, gjatë vitit 1998, janë rishikuar pothuajse të gjitha rregulloret dhe udhëzimet që Banka e Shqipërisë ka nxjerrë për të administruar veprimtarinë e saj ashtu dhe të sistemit bankar më gjerë. Megjithë këto arritje, sfidat kryesore për vitin 1999 kanë të bëjnë me miratimin nga Parlamenti të një grupi ligjesh të reja nga të cilat do të veçonim pjesën bankare të Kodit Civil, ligjin "Për pastrimin e parave", ligjin "Për kolateralin", ligjin "Për garantimin e depozitave" etj.

## 3.2 SEKTORI FINANCIAR DHE RISTRUTURIMI I TIJ.

### 3.2.1 Sistemi Bankar.

Gjatë gjithë periudhës së viteve '90, sektori financiar i vendit nuk mundi të konsolidohej, megjithë përpjekjet e herëpashershme të autoriteteve për krijimin e bazës rregulluese dhe mbikëqyrëse të pjesëmarrësve të këtij tregu. Duhet theksuar se ndërsa sistemi bankar (si pjesë përbërëse e këtij sektori) ka bërë ndryshime të vazhdueshme si në bazën ligjore-rregulluese ashtu dhe në performacën e tij. Pjesa tjetër e këtij sektori, që lidhet me emërtimin, ndërmjetësit dhe ndihmësit financiarë (shoqëritë e pensioneve, bursa, fondet e investimeve, shtëpitë e brokerimit, e deri diku dhe shoqëritë e sigurimit), vazhdon të mos jetë e pranishme duke bërë që dhe roli i tregut financiar të zbehet ndjeshëm.

Është e kuptueshme që ecuria e këtij sistemi ka kaluar nëpër të gjitha zigzaket të cilat iu imponuan ekonomisë gjatë viteve të tranzicionit. Por, i rëndësishëm është fakti se leksionet e kolapsit financiar të vitit 1997, janë marrë dhe po merren gjithnjë e më shumë në konsideratë nga Banka e Shqipërisë, e cila që nga ajo kohë e në vazhdimësi po punon për përmirësimin e bazës ligjore dhe rregullatore.

Gjatë vitit 1998 në Republikën e Shqipërisë filluan veprimtari edhe 2 banka të reja duke e çuar në 10 numrin e bankave përbërëse të sistemit bankar.

**Box 3. Sistemi Bankar në fund të vitit 1998.**

| Bankat                                          | Numri i degëve | Kapitali i paguar ndaj pasivit në % | Totali i depozitave ndaj pasivit në % | Totali i kredive ndaj aktivitetit në % | % e kredive të këqija ndaj totalit të kredive | L/V (bono thesari) në % ndaj sistemit bankar |
|-------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------------|
| <b>Banka shtetërore</b>                         |                |                                     |                                       |                                        |                                               |                                              |
| 1. Banka Kombëtare Tregtare                     | 10             | 12.3                                | 74.3                                  | 5.2                                    | 84.1                                          | 0.7                                          |
| 2. Banka e Kursimeve                            | 33             | 0.3                                 | 88.4                                  | 6.3                                    | 50.7                                          | 97.6                                         |
| <b>Bankat private dhe kapital të përbashkët</b> |                |                                     |                                       |                                        |                                               |                                              |
| 1. Banka Italo Shqiptare                        |                | 19.9                                | 63.4                                  | 41.4                                   | 8.4                                           | 0.5                                          |
| 2. Banka Arabo Shqiptare Islamike               |                | 90.1                                | 10.9                                  | 0.0                                    | 0.0                                           | 0.0                                          |
| 3. Banka Dardania                               |                | 4.3                                 | 12.6                                  | 2.4                                    | 16.5                                          | 0.0                                          |
| 4. Banka Tirana                                 | 2              | 15.7                                | 63.3                                  | 18.0                                   | 20.3                                          | 0.5                                          |
| 5. Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë           |                | 7.0                                 | 81.1                                  | 0.0                                    | 0.0                                           | 0.3                                          |
| 6. Banka Ndërkombëtare Tregtare                 |                | 58.8                                | 48.8                                  | 31.0                                   | 0.0                                           | 0.1                                          |
| 7. Dega e Bankës Alfa Kredit                    |                | 14.7                                | 44.5                                  | 12.5                                   | 0.0                                           | 0.2                                          |
| 8. Banka Amerikane e Shqipërisë                 |                | 32.8                                | 44.5                                  | 0.0                                    | 0.0                                           | 0.0                                          |

Në fund të tremujorit të parë të vitit 1998, nga ana e Bankës së Shqipërisë, u miratua likuidimi i Bankës Tregtare Agrare. Një pjesë e aktivitetit të saj ju kalua Bankës së Kursimeve dhe pjesa tjetër Agjencisë së Trajtimit të Kredive.

Nga pikëpamja e pronësisë, sistemi bankar përbëhet nga 2 banka me kapital shtetëror, 2 banka me kapital të përbashkët dhe 6 me kapital privat. Bankat, në përgjithësi, zhvillojnë një aktivitet universal, duke bërë përjashtim vetëm Banka Arabo Shqiptare Islamike e cila operon me parimet bankare islamike, duke mos pranuar depozita me afat dhe duke mos dhënë kredi.

Këto ndryshime në sistemin bankar kanë ndikuar edhe në përmirësimin e raporteve të veprimtarisë bankare në favor të bankave private, megjithatë, përsëri dominuese në sistemin bankar mbetet Banka e Kursimeve. Kjo, kryesisht, në pranimin e depozitave, si dhe me investime në bono thesari të cilat përfaqësojnë respektivisht 78,8 për qind dhe 97.6 për qind të totalit të bankave të nivelit të dytë.

#### **3.2.1.1 Kapitali, plotësimi i tij.**

Në muajin mars të këtij viti, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi një ndryshim të kapitalit minimal të kërkuar për hapjen e një banke, duke e çuar atë në 700 milionë lekë. Për bankat ekzistuese me kapital nën këtë limit miratoi afate konkrete për plotësimin e tij. Përsa i përket bankave me kapital shtetëror është Banka e Kursimeve që duke dalë në vazhdimësi me rezultat financiar negativ paraqitet me një mungesë të theksuar të fondeve të veta të saj, ndonëse në bilancin e saj paraqitet një kapital i paguar prej rreth 431 milionë lekë.

#### **3.2.1.2 Rentabiliteti dhe mjaftueshmëria e fondeve të veta.**

Sistemi bankar në ROA (kthyeshmërinë nga aktivet) dhe ROE (kthyeshmërinë nga fondet e veta) paraqitet në nivele negative.

Përsa i përket mjaftueshmërisë së fondeve të veta, sistemi bankar në total paraqitet me një mungesë të theksuar të fondeve të veta të korrektuara. Mund të themi se, ndërsa bankat e përbashkëta dhe private paraqiten mjaft të kapitalizuara dhe në nivele mjaft të larta krahasuar me normën e lejuar prej 8 për qind, për grupin e bankave shtetërore, duke ndikuar në këtë grup vetëm një bankë, treguesi është negativ.

#### **3.2.1.3 Respektimi i normave të mbikëqyrjes.**

Në përgjithësi, sistemi bankar është i ndërgjegjësuar për respektimin e normave të vendosura nga Banka e Shqipërisë, megjithatë gjatë vitit 1998 janë vërejtur edhe shkelje të këtyre normave sidomos në drejtim të pozicioneve të hapura në valutë apo në dhënien e kredisë një huamarrësi mbi normën e lejuar. Për shkeljet e vërejtura, nga ana e Bankës së Shqipërisë, është mbajtur qëndrim ndaj bankës përkatëse mbështetur kjo në kërkesën e nenit 44 të ligjit "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

**3.2.1.4 Klasifikimi i huave.**

Kreditë e pakthyera në afat, ndonëse paraqiten me ulje teprice, krahasuar me fundvitin 1997, përsëri përbëjnë 41 për qind të tepricës së kredive gjithsej.

Klasifikimi i portofolit të huave tregon për një përkeqësim të mëtejshëm të portofolit të huadhënies. Kështu 55.5 për qind e portofolit të huave përbëhet nga kreditë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura ose 41,5 për qind përbëhet vetëm nga kreditë e humbura (në këtë tregues nuk janë përfshirë të dhënat e ish Bankës Tregtare Agrare për faktin që kreditë e saj i kanë kaluar Agjencisë së Trajtimit të Kredive). Huatë e klasifikuara si të humbura në dy bankat me kapital shtetëror përfaqësojnë 98,3 për qind të kredive të humbura të krejt sistemit bankar. Megjithatë, në cilësinë e portofolit të huave në këto banka kanë influencuar kreditë e marra kryesisht nga Banka Tregtare Agrare, nëpërmjet thithjes së shumë degëve të kësaj banke, dhe që në këtë fushë paraqitej me shumë probleme. Sistemi bankar, për mbulimin e humbjeve nga kreditë, ka krijuar, sipas rregullores përkatëse të Bankës së Shqipërisë edhe provigjonet përkatëse duke mbuluar me këto fonde të krijuara 46,9 për qind të krejt portofolit.

**3.2.2 Reformat në sistemin bankar.**

Reforma në sistemin bankar në Shqipëri është përqëndruar në drejtimet e mëposhtme:

Së pari, në shmangien e ndërhyrjes së shtetit “në punët” e sistemit bankar, në mënyrë që sistemi bankar të zhvillohet mbi bazën e parimeve të ekonomisë së tregut. Është gjykuar se privatizimi apo likuidimi i bankave shtetërore ekzistuese është një moment shumë i rëndësishëm për të arritur këtë objektiv.

Së dyti, në krijimin e një infrastrukture të përshtatshme ligjore, e cila do t’u krijojë bankave mundësinë që të zhvillojnë aktivitetin e tyre mbi bazën e parimeve tregtare. Kjo përfshin mbështetjen e duhur ligjore, juridike dhe politike (veçanërisht në lidhje me falimentimin, kolateralin, regjistrimin e aseteve të luajtshme dhe problemeve të tjera të lidhura me to); një sistem të shëndoshë rregullator; aftësitë e duhura mbikëqyrëse dhe infrastrukturën bazë financiare (pagesat, kontabilitetin dhe kontrollin).

**3.2.2.1 Privatizimi i bankave.**

Megjithëse aktiviteti kreditues gjatë vitit të kaluar ka qenë shumë i ulët, përsëri vazhdon të shfaqet dukuria e moskthimit të huave të dhëna nga bankat shtetërore. Vlerësimi i kreditit dhe disiplina në bankat shtetërore është në nivele aq të ulëta sa rrugëdalja e vetme nga kjo situatë u gjykua privimi i bankave shtetërore nga dhënia e kredisë së re ekonomisë përgjatë gjithë vitit 1998. Megjithë përpjekjet e bëra deri në vitin 1996 për ristrukturimin e bankave në mënyrë që të ndërtohej një sistem bankar funksional, realiteti tregoi se menaxhimi shtetëror me kritere politike e

partiake ishte i paefektshëm dhe për rrjedhim dështimi ishte i pashmangshëm.

Reduktimi i pranisë dhe i rolit të shtetit në banka do të ndihmojë dhe do t'i çelë rrugën edhe lulëzimit të bankave private, të cilat do të shndërrohen në burim krediti vetëm për klientë të besueshëm që kanë operuar dhe më parë me bankat. Aktualisht, kredia e akorduar nga bankat private është në nivele shumë të ulëta, megjithëse pjesa e kredisë së akorduar sektorit privat nga bankat private ka pësuar rritje të vazhdueshme.

Hapi i parë për zbatimin e programit të privatizimit të bankave ishte mbyllja e Bankës Tregtare Agrare në dhjetor 1997, banka më e vogël ndër tre bankat shtetërore dhe që kishte më pak shpresa për t'u privatizuar. Gjithashtu, Qeveria ka krijuar dhe Agjencinë e Trajtimit të Kredive (ATK) e cila do të jetë përgjegjëse për mbledhjen e huave të këqija të bankave shtetërore dhe normalisht do të krijojë një lloj disipline në tregun e kreditit. Ndryshe nga viti i kaluar, prej saj priten rezultate më konkrete në mbledhjen e huave.

Hapa pasues janë bërë gjatë vitit 1998 dhe në drejtim të privatizimit të dy bankave të tjera shtetërore. Ministria e Financave ka emëruar një administrator të huaj për BKT i cili e ka bankën nën kontroll dhe po e çon atë drejt privatizimit të plotë, për ta përfunduar si proces brenda vitit 1999.

Përsa i përket Bankës së Kursimeve (BK), është nënshkruar një kontratë menaxhimi me këshillin drejtues të saj, kontratë e cila ka për qëllim final përgatitjen e kësaj banke për privatizim. Për më tepër, një bankë e huaj është caktuar për zbatimin e kësaj kontrate. Përfaqësuesit e kësaj banke do të jenë pjesë e stafit drejtues të Bankës së Kursimeve. Hap tjetër shumë i rëndësishëm do të jetë dhënia e të drejtës së vetos administratorëve të huaj në lidhje me vendimet për probleme që kanë të bëjnë me kreditin dhe personelin. Është planifikuar që privatizmi i BK të fillojë në fund të vitit 1999.

Sidoqoftë, Banka e Shqipërisë vlerëson se hapat privatizues me të dyja bankat kanë qenë më të ngadalshëm se mundësitë dhe kërkon që ky proces të shpejtohet më tej dhe të marrë fund brenda vitit 1999.

### **3.2.2.2 Kostoja fiskale e privatizimit të bankave.**

Rikapitalizimi i dy bankave shtetërore për qëllime të privatizimit do të ketë një kosto mjaft të lartë, në dhjetra milionë dollarë. Kostoja e rikapitalizimit do të përfshijë shumën e nevojshme që bankat të arrijnë shifrën 8 për qind për mjaftueshmërinë e kapitalit.

### **3.2.2.3 Kuadri rregullator i bankave.**

Gjatë vitit 1998, u ndërmorën hapa konkretë për përmirësimin e ligjeve dhe rregulloreve të sektorit financiar, duke filluar me rishikimin e ligjit "Për Sistemin Bankar në Shqipëri" në mënyrë që të sigurohet kapitalizimi i duhur i bankave dhe rregullat e duhura për hyrjen dhe daljen nga sistemi bankar.

Minimumi i kapitalit rregullues për bankat është rritur nga 200 milionë lekë që ishte në 1996, 350 milionë lekë në 1997 dhe më tej në 700 milionë lekë në prill 1998. Kërkesat për licencim janë përforcuar dhe kërkojnë përfshirjen e informacioneve shtesë lidhur me planet e biznesit dhe kualifikimin e drejtuesve. Nën dritën e këtyre rishikimeve, të gjitha bankat tregtare të licencuara për të ushtruar aktivitet bankar në Shqipëri do t'i nënshtrohen shqyrtimit për të përmbushur me përpikëri kriteret e reja të vendosura nga kjo rregullore.

Në rishikimin e kuadrit rregullator Banka e Shqipërisë do të rrisë raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit nga 8 për qind në 12 për qind. Një problem tjetër, mjaft i madh, është dhe mbivlerësimi që bankat i bëjnë kapitalit të tyre, fenomen i cili rrjedh nga mosrishikimi (korrigjuar) siç duhet i llogarive të tyre lidhur me aktivet e këqija. Për këtë qëllim po rishikohen praktikat dhe procedurat aktuale që bankat ndjekin për vlerësimin e mjeteve, klasifikimin e huave dhe do të miratohen masat korrigjuese që nevojiten.

Së fundi, ndërsa janë ndërmarrë hapa pozitivë për krijimin e një strukture ligjore dhe rregullatore të nevojshme për funksionimin e sistemit bankar sipas parimeve të tregut dhe ndërsa rregulloret e mbikëqyrjes bankare janë përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, ka akoma mjaft probleme lidhur me zbatimin e këtyre rregulloreve çka duhet parë me mjaft kujdes.

#### **3.2.2.4 Mbikëqyrja bankare.**

Banka e Shqipërisë gjatë gjithë viteve të fundit është asistuar teknikisht nga burime të huaja përsa i përket mbikëqyrjes bankare. Është hartuar manuali për inspektimin e bankave të nivelit të dytë dhe përdoret nga inspektorët për këtë qëllim. Megjithëse ka patur mjaft përparime në procedurat dhe teknikat e inspektimit të bankave, akoma ka mjaft për t'u bërë në zbatimin e tyre.

#### **3.2.2.5 Infrastruktura financiare.**

Nga autoritetet është planifikuar që të krijohet zyra e informacionit mbi kreditin. Kjo zyrë do të mbajë të gjithë informacionin bazë për besueshmërinë e klientëve që kërkojnë kredi nga bankat. Krijimi i kësaj zyre do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të riskut të kredisë bankare dhe do të lehtësojë procedurat e ndërmjetësimit në Shqipëri.

Sistemi i pagesave është një element kryesor në një sistem bankar modern. Fatkeqësisht deri tani nuk është ndërtuar një sistem i tillë por, Banka e Shqipërisë është e ndërgjegjshme për domosdoshmërinë e tij dhe ka marrë hapa konkretë në këtë drejtim.

Kontabiliteti dhe kontrolli kanë patur zhvillime të rëndësishme kohët e fundit. Këshilli i Ministrave ka miratuar planin e ri të llogarive i cili përputhet me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe do të jetë i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha bankat që kryejnë aktivitet në Shqipëri. Këto banka kanë hartuar llogaritë e tyre për vitin 1997 mbi bazën e Standardeve

Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe kanë filluar aplikimin e tij që në prill 1998. Gjithashtu, po punohet vazhdimisht për të modifikuar formatin e raporteve të detyrueshme të mbikëqyrjes së bankave duke u bazuar në planin e ri të llogarive dhe rregulloret aktuale të Bankës së Shqipërisë.

### **3.2.2.6 Tregjet e tjera financiare.**

Bursa e Tiranës e hapur në maj 1996 vazhdon të ketë një aktivitet të kufizuar në tregtimin e bonove të thesarit në tregun sekondar. Këto bono tregtohen vetëm nga bankat shtetërore prandaj duhen marrë masa që ky treg të zhvillohet më tej. Kjo do t'i bënte bonot e thesarit më atraktive për investitorët individualë dhe do t'u siguronte atyre një instrument alternativ investimi.

Duhet theksuar se aktualisht, roli i Bursës së Tiranës është shumë larg të qenit një institucion financiar i rëndësishëm për ekonominë dhe financat e vendit. Mund të themi që ky, si institucion, është praktikisht inekzistent dhe rishikimi i kuadrit rregullator dhe institucional të tij përbën një nga prioritetet e zhvillimit afatshkurtër ekonomik dhe financiar të vendit.

Eksperiencia e deritanishme e disa programeve donatore që kanë eksperimentuar me fonde huash për zonat rurale ka dëshmuar se këto fonde mund të shndërrohen në kooperativa kreditimi apo huaje. Kjo qëndron veçanërisht për ato zona ku të ardhurat janë aq të larta sa gjenerojnë kërkesë për kredit. Është e domosdoshme që të rishikohet dhe të sigurohet baza ligjore e nevojshme përpara se të krijohet ky lloj i ri institucioni financiar.

Si konkluzion, mund të themi se sistemi bankar është në një proces të gjerë reformimi sidomos gjatë këtyre viteve të fundit. Janë marrë mjaft masa në drejtim të privatizimit dhe likuidimit të bankave. Është mjaft i rëndësishëm vazhdimi i zbatimit të reformës pasi kjo është mundësia e vetme për të ndërtuar një sistem financiar të shëndoshë dhe eficient. Duhet të krijohet mbështetja e duhur infrastrukturore dhe ligjore në mënyrë që bankat të operojnë mbi bazën e parimeve të duhura tregtare. Proceset ligjore dhe juridike duhet të përforcohen në mënyrë që të mbështesin sistemin e kreditimit dhe zbatimin e kontratave financiare.

#### 4. EMISIONI I MONEDHËS

Gjatë vitit 1998, janë **emetuar** gjithsej në sektorin metalik të Shtypshkronjës së Bankës së Shqipërisë 2 650 834 copë monedha metalike të prerjes 5 lekë dhe 1 210 000 copë të prerjes 1 lek, që në vlerë japin shumën 14 464 170 lekë.

Ndërkohë **Monedha në qarkullim**, rezulton në shumën 69.369.443.974,90 lekë dhe ka pësuar një pakësim në raport me një vit më parë për shumën 4.744.071.572 lekë, çka tregon një përmirësim të raportit të parasë jashtë bankave kundrejt parasë gjithsej (M3). Struktura e monedhës në qarkullim në fund të viteve 1997 dhe 1998 dhe ndryshimi i saj jepet në Shtojcën Statistike nr.7.

Si faktorë kryesorë që kanë ndikuar drejtpërdrejt në pakësimin e monedhës në qarkullim gjatë këtij viti, janë rritja e nivelit të depozitave në lekë dhe ruajtja në nivele afër konstante e kursit të këmbimit të lekut me valutat.

Gjatë vitit, janë **asgjësuar** gjithsej 33.022.516 copë kartëmonedha dhe në vlerë 4.251.561.600 lekë. Po të verejmë dinamikën e asgjësimit të kartëmonedhave të dëmtuara që nga viti 1994 shohim se përqindjen më të lartë në dëmtim e zë kartëmonedha e prerjes 100 lekë.

**Kartëmonedha kombëtare e fallsifikuar** përgjatë vitit 1998 rezulton:

| Prerjet   | Viti 1998 |
|-----------|-----------|
| 200 lekë  | 1 copë    |
| 500 lekë  | 521 copë  |
| 1000 lekë | 103 copë  |

Raste më të shumta fallsifikimi janë ato të prerjes 500 lekë, emetimi i vitit 1994.

Mund të thuhet se tregu shqiptar nuk ka mundur t'i shpëtojë edhe pranisë së **kartëmonedhave valuta të fallsifikuara**. Valutat e fallsifikuara i përkasin të katër monedhave kryesore që operojnë në tregun shqiptar: *dollari amerikan, lireta italiane, dhrahmia greke dhe marka gjermane*. Një vend të veçantë zë prerja 100 USD emetim i vitit 1990. Është fakt që cilësia e fallsifikimit ndryshon për secilin lloj të valutës dhe, akoma më shumë, për një valutë të caktuar mund të gjesh dy ose më shumë mënyra fallsifikimi.

## **5. SISTEMI I PAGESAVE NË SHQIPËRI**

### **5.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM.**

**S**istemi i Pagesave në Shqipëri vazhdon të përbëjë një nga pikat e dobëta të sistemit bankar dhe financiar të vendit. Gjatë vitit 1998 puna u përqëndrua kryesisht në identifikimin e problemeve që ai paraqet dhe hartimin e strategjisë (afatmesme dhe afatgjatë) për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe përmirësimin e Sistemit të Pagesave. Aktualisht Sistemi i Pagesave në Shqipëri paraqitet:

#### **5.1.1 Instrumentet e Pagesave.**

Instrumenti i pagesës më i përdorur, që është në të njëjtën kohë edhe mënyra më klasike e pagesës, është *cash*-i.

Një instrument tjetër i përdorur nga ana e subjekteve të ndryshme private dhe shtetërore, është urdhër-xhirimi, i cili është një instrument kreditor dhe si i tillë, nuk mbart me vete riskun e mospagesës. Por, duke qenë një instrument i bazuar në letër, koha e përpunimit të tij është relativisht e gjatë dhe në këtë mënyrë, përdorimi i tij nuk u ofron shpejtësinë e duhur klientëve të bankave.

Aktualisht, një përdorim në rritje po gjen edhe çeku bankar dhe personal. Megjithë progresin e bërë, përsëri përdorimi i tyre është i kufizuar. Më tepër përdorim ka gjetur çeku bankar i cili, duke qenë i garantuar nga banka lëshuese, eliminon riskun e mospagesës si risku kryesor i instrumenteve debitoare. Ndikim ka ushtruar edhe nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërbankare për këtë qëllim. Por, edhe çeku, duke qenë instrument i bazuar në letër nga njëra anë dhe duke qenë më i riskueshëm si instrument debitor nga ana tjetër, nuk ofron shpejtësinë dhe sigurinë e duhur tek klientët.

Pra, siç shihet, sot në sistemin tonë të pagesave, përdoren dhe shkëmbehen për qëllime të shlyerjes së detyrimeve monetare vetëm instrumente të bazuara në letër.

#### **5.1.2 Infrastruktura e transportimit dhe shkëmbimit.**

Një rëndësi të madhe në sistemin e pagesave ka edhe infrastruktura e përdorur për transferimin e instrumenteve dhe për shkëmbimin dhe rregullimin e tyre mes bankave. Sot, kjo infrastrukturë mbështetet në transportimin fizik të dokumenteve të pagesave ndërmjet degëve të bankave, drejtorive të përgjithshme dhe Bankës së Shqipërisë<sup>19</sup>.

---

<sup>19</sup> Ky transportim realizohet nga Sistemi Korrier i organizuar nga Banka e Shqipërisë, i cili funksionon sipas një skeme qarkullimi që ndryshon vazhdimisht në funksion të nevojave të bankave që e përdorin.

Shkëmbimi i këtyre instrumenteve mes bankave të ndryshme realizohet në Zyrën e Kleringut pranë Bankës së Shqipërisë, në të cilën sipas procedurave dhe rregulloreve të caktuara dhe të rëna dakord mes bankave, kryhet shkëmbimi fizik i këtyre dokumenteve. Seancat e kleringut realizohen mbi bazë multilaterale neto, pra është rezultati neto i seancave të kleringut i cili rregullohet në llogaritë përkatëse të tyre pranë Bankës së Shqipërisë.

**Box 4. Volumi i transaksioneve të kaluara në seancat e kleringut për vitin 1998**

| Instrumenti       | Volumi        | Vlera                 | Vlera mesatare        |                      |
|-------------------|---------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|
|                   | <i>Numri</i>  | <i>Vlera</i>          | <i>për instrument</i> | <i>mujore</i>        |
| <b>U – Xhirim</b> | 43,183        | 22,161,674,721        | 513,204               | 1,846,806,226        |
| <b>Cek</b>        | 4,837         | 15,538,478,971        | 3,212,421             | 1,294,873,247        |
| <b>Totali</b>     | <b>48,020</b> | <b>37,700,153,692</b> |                       | <b>3,141,679,474</b> |

Gjatë vitit 1998 Banka e Shqipërisë ndërmori disa hapa dhe bëri disa ndryshime në drejtim të Sistemit të Pagesave, të cilat ende duhet të konsiderohen si hapa të ndërmjetëm, që do të shërbejnë për të lehtësuar procesin e kalimit nga sistemi aktual në një sistem më të avancuar.

## 6. BILANCI KONTABËL DHE REZULTATI FINANCIAR

| A K T I V I                                               | Dhjetor 98         | Dhjetor 97         |
|-----------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| <b>1. Ar &amp; metale të çmuara</b>                       | <b>2,389,188</b>   | <b>2,580,189</b>   |
| <b>2. Pretendime ndaj Qeverisë</b>                        | <b>75,767,671</b>  | <b>87,585,780</b>  |
| 2.1. Letra me vlerë të qeverisë                           | 4,114,934          | 5,395,752          |
| 2.2. Bono thesari                                         | 15,033,004         | 28,478,000         |
| 2.3. Kredi Qeverisë                                       | 56,619,733         | 53,712,028         |
| 2.3.1. Kredi Qev.për mbulim buxh' 92 – 94                 | 32,258,140         | 32,258,140         |
| 2.3.2. Bono thesari për mbulim buxheti                    | 24,361,593         | 21,453,888         |
| <b>3. Kredi bankave &amp; institucioneve financiare</b>   | <b>6,996,398</b>   | <b>6,041,599</b>   |
| <b>4.Kërkesa ndaj bankave të huaja &amp; inst. financ</b> | <b>88,157,397</b>  | <b>81,907,312</b>  |
| 4.1. Depozita pa afat & llogari rrjedhëse                 | 5,206,865          | 5,783,859          |
| 4.2. Depozita me afat                                     | 42,732,921         | 42,474,390         |
| 4.3. Letra me vlerë në llogari besimi                     | 31,630,500         | 33,556,500         |
| 4.4. Zotërimi në SDR                                      | 8,587,111          | 92,563             |
| <b>5.Kuotizacione të institucioneve ndërkombëtare</b>     | <b>10,046,582</b>  | <b>9,773,143</b>   |
| <b>6.Detyrime për t'u marrë</b>                           | <b>19,367,769</b>  | <b>11,027,396</b>  |
| 6.1. Afatshkurtër                                         | 16,450,155         | 7,963,301          |
| 6.2. Afatgjatë                                            | 2,917,614          | 3,064,095          |
| <b>7. Aktive të qëndrueshme</b>                           | <b>730,189</b>     | <b>985,585</b>     |
| <b>8. Aktive të tjera</b>                                 | <b>-5,031,332</b>  | <b>-8,872,699</b>  |
| <b>TOTALI I AKTIVEVE</b>                                  | <b>198,423,862</b> | <b>191,028,305</b> |

| P A S I V I                                                 | Dhjetor 98         | Dhjetor 97         |
|-------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
|                                                             |                    |                    |
| <b>1. Para në qarkullim</b>                                 | <b>69,394,532</b>  | <b>74,119,271</b>  |
|                                                             |                    |                    |
| <b>2. Depozita të Qeverisë</b>                              | <b>5,580,449</b>   | <b>5,624,526</b>   |
|                                                             |                    |                    |
| <b>3. Depozita të bankave vendase</b>                       | <b>20,491,984</b>  | <b>16,807,902</b>  |
|                                                             |                    |                    |
| 3.1. Depozita & llog. rrjedhëse                             | 3,540,372          | 4,803,520          |
| 3.2. Rezerva e detyrueshme                                  | 16,951,612         | 12,004,382         |
|                                                             |                    |                    |
| <b>4. Detyrime ndaj bankave të huaja &amp; inst.financ.</b> | <b>19,746,591</b>  | <b>16,592,174</b>  |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>5. Llogaritë e organizmave ndërkombëtarë</b>             | <b>9,646,643</b>   | <b>9,383,097</b>   |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>6. Detyrime për t'u paguar</b>                           | <b>35,005,359</b>  | <b>37,066,701</b>  |
|                                                             |                    |                    |
| 6.1 Afatshkurtër                                            | 0                  | 0                  |
| 6.2. Afatgjatë                                              | 3,374,859          | 3,510,201          |
| 6.3. Obligacione (të kolateruara)                           | 31,630,500         | 33,556,500         |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>7. Fondi i themelimit</b>                                | <b>750,000</b>     | <b>750,000</b>     |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>8. Rezerva ligjore</b>                                   | <b>3,750,000</b>   | <b>2,050,000</b>   |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>9. Rezerva të tjera</b>                                  | <b>7,208,833</b>   | <b>8,760,390</b>   |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>10. Rivlerësimi i rezervës</b>                           | <b>6,906,636</b>   | <b>8,113,981</b>   |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>11. Fitim i pashpërndarë</b>                             | <b>1,094</b>       | <b>105,808</b>     |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>12. Fitim e humbje</b>                                   | <b>19,941,741</b>  | <b>11,654,455</b>  |
|                                                             |                    |                    |
|                                                             |                    |                    |
| <b>TOTALI I PASIVEVE</b>                                    | <b>198,423,862</b> | <b>191,028,305</b> |

## **6.1 PARIMET E KONTABILITETIT DHE METODAT E VLERËSIMIT.**

### **6.1.1 Parimet e përgjithshme.**

**P**asqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, ligjin “Për Kontabilitetin” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Këto të fundit janë zbatuar vetëm atëherë kur janë konsideruar të përvetësuar dhe pasi janë kontrolluar nga ekspertët e FMN-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me koston historike dhe rregullat e vlerësimit paraqiten në shënimet e mëposhtme.

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” neni 74, Banka e Shqipërisë përjashtohet nga tatimi dhe taksat. Ky nen nuk është zbatuar, pasi në bilancin e Bankës së Shqipërisë pasqyrohet TVSH-ja në shumën 35.5 milionë lekë, e cila nuk është rimbursuar nga organet fiskale, dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve pasqyrohet zëri taksa në shumën 9.8 milionë lekë.

Pasqyrat financiare të vitit '98 për herë të parë u publikuan në formën e bilancit përmbledhës.

### **6.1.2 Metodat e vlerësimit.**

#### **▪ Të ardhurat dhe shpenzimet.**

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara janë kaluar në llogarinë fitime dhe humbje në bazë të parimit me baza *cash*-i (kur janë arkëtuar dhe paguar paratë).

Gjatë periudhës gusht-nëntor '98 të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara kanë kaluar në llogarinë fitime dhe humbje në bazë të parimit të përlllogaritjeve. Fitimet dhe humbjet e përealizuara janë kaluar në llogarinë e rezervave.

#### **▪ Vlerësimi i monedhës së huaj.**

Mjetet dhe burimet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën shqiptare (Lek) duke përdorur kursin e këmbimit sipas tabelës së kurseve të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e veprimt, ndërsa në hartimin e pasqyrave financiare është përdorur kursi i këmbimit i datës 31 dhjetor 1998.

Fitimet dhe humbjet e përealizuara si efekt i konvertimit me kursin e datës 31.12.1998 janë kaluar në llogarinë “Rivlerësim i Rezervës”.

Kurset e këmbimit për monedhat e huaja kryesore të përdorura më 31 dhjetor 1997 dhe 1998 janë si më poshtë:

Tabela 10. Kursi i këmbimit 31.12.1999.

| Monedha | Njësia | Kursi i valutave 1998 | Kursi i valutave 1997 |
|---------|--------|-----------------------|-----------------------|
| USD     | 1      | 140.58                | 149.14                |
| DEM     | 1      | 83.94                 | 83.33                 |
| ITL     | 1000   | 84.78                 | 84.82                 |
| SDR     | 1      | 197.90                | 201.23                |

▪ **Ar , Argjend dhe metale të çmuara.**

Ari dhe Argjendi janë vlerësuar me kursin fiks të Londrës të datës 31 dhjetor 1998, ku

1 onz ar = 287.45 USD dhe 1onz argjend = 5.02 USD.

Humbjet dhe fitimet nga rivlerësimi janë kaluar në kredi të llogarisë “Rivlerësim i Arit dhe Argjendit”.

Metalet e çmuara paraqiten në bilanc me vlerën e regjistruar kontabile (kostoja historike) pasi nuk bëhet rivlerësim i tyre për mungesë kursi në treg.

Në dallim nga vitet e tjera, ku rivlerësimi bëhej një herë në vit dhe në disa raste edhe një herë në dy vjet, gjatë vitit '98 rivlerësimi i Arit dhe Argjendit bëhet çdo muaj.

▪ **Letrat me Vlerë.**

Bonot e thesarit janë të vlerësuara me vlerën nominale, ndërsa skontoja totale mbahet gjatë muajit në llogari të pasivit të bilancit dhe në fund të muajit kalon në aktiv me minus (-) për të korrigjuar vlerën e bonove të thesarit me çmimin e blerjes.

Gjatë periudhës (gusht-nëntor '98) si rezultat i ndryshimit të metodës së mbajtjes së kontabilitetit nga baza *cash*-i në atë me të drejta të konstatuara, bonot e thesarit u vlerësuan me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet e parealizuar nga rivlerësimi u kaluan në llogarinë “rivlerësim i bonove të thesarit”, ndërsa fitimet e realizuara u kaluan në llogarinë “fitim e humbje”. Kjo politikë kontabile u kontrollua nga misioni i FMN-së dhe u pranua që është në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS).

“Bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjes së riblerjes” janë vlerësuar me çmimin e blerjes. Shpenzimet dhe të ardhurat nga interesat e “Repo-ve” dhe “Repo-ve të anasjellta” kanë kaluar në llogaritë e rezultatit, në ndryshim nga periudhat e kaluara ku operohej me zbritjen e bonove të thesarit.

Në përputhje me rregulloren për “Marrëveshjen e Riblerjes” sipas së cilës “Repo” trajtohet një herë si blerje dhe shitje e plotë e bonove të thesarit dhe

një herë si kredi e kolateralizuar, janë hartuar procedurat kontabile për pasqyrimin e transaksioneve të Riblerjes. Këto procedura u vlerësuan nga misioni i FMN-së dhe u konsideruan që janë në përputhje me IAS. U rekomandua, gjithashtu, që të fiksohet në të ardhmen që "Repo" të trajtohet vetëm si kredi e kolateralizuar sipas praktikave të bankave qendrore.

▪ ***Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet.***

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet janë vlerësuar me vlerën nominale të tyre, pra me vlerën që figuron në kontabilitet (vlera e regjistruar).

▪ ***Aktivët e qëndrueshme.***

Aktivët e qëndrueshme, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, janë vlerësuar me koston e blerjes (parimi i kostos historike) të korrigjuara me amortizimin. Amortizimi është llogaritur duke zbatuar metodën e amortizimit linear bazuar në jetëgjatësinë e mjetit dhe normave të amortizimit të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Nuk është bërë asnjë rivlerësim i mjeteve të qëndrueshme për t'i pasqyruar me vlerën reale të tregut.

▪ ***Fondi i themelimit dhe rezervat.***

Fondi i themelimit dhe rezervat paraqiten në bilanc me vlerën që figuron në kontabilitet (vlera e regjistruar). Në përputhje me ligjin e Bankës së Shqipërisë ato janë:

|                         |                                                           |
|-------------------------|-----------------------------------------------------------|
| Fondi i themelimit:     | 750 milionë lekë                                          |
| Rezerva e përgjithshme: | 3,750 milionë lekë (500 për qind e fondit të themelimit). |

## 6.2 SHËNIME PËR BILANCIN KONTABËL, LLOGARITË JASHTË BILANCIT DHE LLOGARITË HUMBJE FITIME.

### 6.2.1 Bilanci kontabël.

Për vitin 1998, në zbatim të parimit të krahasimit, kemi një rritje të aktiveve dhe pasiveve në raport me vitin 1997, në shumën 7.4 miliardë lekë.

#### ▪ Ar dhe metale të çmuara.

Vlera e rezervës së arit dhe metaleve të çmuara të administruara nga Banka e Shqipërisë është 2,389 milionë lekë.

Banka administron në total rreth 54,899.474 onz ar, vlerësuar me kursin fiks të Londrës të datës 31.12.98, në të cilin 1 onz ar = 287.45 USD .

Ky zë nuk përfshin 62,198.312 onz ar pranë bankave të huaja.

Zëri "Ar dhe metale të çmuara " në vitin '98 në krahasim me vitin '97 është zvogëluar me 191 milionë lekë. Kjo është rezultat i rivlerësimit, në të cilin kursi i vlerësimit të arit ka pësuar rënie (në vitin 1997 një onz ar = 289.2 dollarë).

#### ▪ Pretendime ndaj Qeverisë.

Zëri "Pretendime ndaj Qeverisë" gjatë vitit '98 është ulur me 11,818 milionë lekë.

**Tabela 11. Pretendime ndaj Qeverisë (në mijë lekë).**

|                                              | 1998       | 1997       | Ndryshimi    |
|----------------------------------------------|------------|------------|--------------|
| Letra me vlerë të qeverisë                   | 3,034,212  | 2,973,212  | 61,000       |
| Bono thesari me afat                         | 15,033,004 | 28,478,000 | - 13,444,996 |
| Kredi Qeverisë                               | 56,619,733 | 53,712,028 | 2,907,705    |
| - Kredi Qeverisë për mbulim buxheti          | 32,258,140 | 32,258,140 | 0            |
| - Bono thesari për mbulim buxheti            | 24,361,593 | 21,453,888 | 2,907,705    |
| Letra me vlerë të qeverisë për mbulim humbje | 437,722    | 1,718,540  | -1,280,818   |
| Të arkëtueshme int."oblg. Qeveritare"        | 643,000    | 704,000    | -61,000      |
| Totali                                       | 75,767,671 | 87,585,780 | - 11,818,109 |

**13,445** milionë lekë është zvogëluar portofoli i "bonove të thesarit me afat "

**2,908** milionë lekë është rritur kredia për Qeverinë dhe konkretisht "bono thesari për mbulim buxheti", shumë e cila përbën mbulimin e buxhetit të vitit 1998, që është 3,384 milionë lekë dhe diferenca për 476 milionë lekë është ulja e këtij portofoli për vitet 1994-97.

**1,281** milionë lekë është pakësuar llogaria “letra me vlerë të Qeverisë për mbulim humbje” nga shpërndarja e fitimit të vitit 1997.

▪ **Kredi bankave dhe institucioneve financiare.**

Ky zë është rritur me 955 milionë lekë, kryesisht si pasojë e lëvrimit të kredisë së dhënë për Aeroportin e Rinasit me rreth 9 milionë DEM.

▪ **Kërkesa ndaj bankave të huaja dhe institucioneve financiare.**

Ky grup llogarish ka një rritje prej 6,250 milionë lekë e cila përbëhet:

**Tabela 12. Kërkesa ndaj bankave të huaja dhe institucioneve financiare.**

| Në mijë lekë                       | 1998              | 1997              | Diferenca        |
|------------------------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Depozita pa afat & llog. rrjedhëse | 5,206,865         | 5,783,859         | - 576,994        |
| Depozita me afat                   | 40,202,180        | 41,989,668        | - 1,787,488      |
| Depozita ari me bankat e huaja     | 2,530,741         | 484,722           | 2,046,019        |
| Letra me vlerë në llogari besimi   | 31,630,500        | 33,556,500        | - 1,926,000      |
| Zotërimi në SDR                    | 8,587,111         | 92,563            | 8,494,548        |
| <b>Totali</b>                      | <b>88,157,397</b> | <b>81,907,312</b> | <b>6,250,085</b> |

▪ Depozita pa afat është ulur me **577** milionë lekë si pasojë e uljes së kursit të valutave me rreth 320 milionë lekë dhe uljes së gjendjes së tyre 257 milionë lekë.

▪ Depozitat me afat janë rritur **259** milionë lekë:

- Depozita me afat në valutë të huaj, është zvogëluar me 1,787 milionë lekë, nga e cila 620 milionë lekë është zvogëlim depozite dhe 1,167 milionë lekë është nga ulja e kursit të valutave.

